



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI
SHTËPIA E FOSHNJES “LULET E VOGLA” KORÇË**

**RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI
FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIE**

NË

BASHKINË KORÇË

SHTËPIA E FOSHNJES “LULET E VOGLA” KORÇË

JANAR 2023

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3-9
1.	Përshkrimi i shkurtër i auditimit	
2.	Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit	
II.	HYRJA	10-13
1.	Objekti i Auditimit	
2.	Qëllimi i Auditimit	
3.	Identifikimi i çështjes	
4.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
5.	Përgjegjësitë e audituesve	
6.	Kriteret e vlerësimit	
7.	Standardet e auditimit	
8.	Metodat e auditimit	
9.	Dokumentimi i auditimit	
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	14-55
1.	Informacion i përgjithshëm për subjektin nën auditim	
2.	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit	
2.1	Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit	16-26
2.2	Mbi administrimin e pronës shtetërore	27-34
2.3	Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare	34-35
2.4	Auditimi i llogarive vjetore	36-39
2.5	Prokurimet e fondeve publike	40-49
2.6	Probleme të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit	50-54
IV.	GJETJET DHE REKOMANDIMET	56-60
V.	ANEKSE	61-62

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Auditimit.

Në Shqipëri funksionon një rrjet institucionesh të përkujdesit shoqëror (IPSH), të cilat ofrojnë shërbime për kategoritë në nevojë. IPSH-të publike financohen nga shteti nëpërmjet Shërbimit Social Shtetëror ose Bashkive dhe menaxhohen në nivel qendror dhe lokal.

Shtëpia e Foshnjës Korçë është institucion shtetëror rezidencial nën varësinë e Bashkisë Korçë. Ky institucion e zhvillon veprimtarinë e tij në bazë të Ligjit Nr.9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore dhe akteve nënligjore në zbatim të tij si dhe në përputhje me Konventën "Mbi të drejtat e fëmijës" dhe kartën e "Të drejtave të njeriut".

Shtëpia e Foshnjës "Lulet e Vogla" Korçë, ofron shërbim rezidencial të përkujdesit shoqëror për fëmijët në nevojë dhe është në varësi të Shërbimit Social Shtetëror dhe Bashkisë Korçë.

Misioni i Shtëpisë së Foshnjës është zbatimi dhe zbërthimi i strategjive dhe politikave, në përputhje me programin politik të Qeverisë dhe SHSSH zbatimi i Legjislacionit në fuqi dhe kërkesave që parashtrohen në standartet kombëtare, që si parim bazë kanë interesin e lartë të fëmijës, për mirërritjen, kujdesin shëndetësor dhe social për fëmijët me probleme sociale. Ajo krijon kushtet dhe karakteristikat e një ambienti familjar, integrimin e fëmijëve në ambientet jashtë institucionit, vendosjen e fëmijëve në mjedise familjare me përparësi atë të origjinës.

Shtëpia ka si qëllim mirërritjen, kujdesin shëndetësor dhe social për fëmijet, edukimin, arsimimin dhe trajtimin psiko-social të fëmijëve. Ai krijon për fëmijet kushtet dhe karakteristikat e një ambienti familjar, integrimin e tyre në ambientin jashtë institucionit, vendosjen e fëmijëve në mjedis familjar, me përparësi atë të origjinës. Objektivat e institucionit janë:

- Të ofrojë një mjedis të sigurt dhe mbështetës për fëmijët me probleme sociale. Fëmijë me probleme sociale janë fëmijët e braktisur, fëmijët e familjeve shumë të varfëra, fëmijët me prindër të divorcuar, fëmijë të prindërve të cilëve u është hequr e drejta prindërore.

- Të hartojë programe individuale kujdesi për fëmijët që ata të kenë mundësi të zhvillojnë shprehitë e tyre dhe të maksimalizojnë potencialin nëpërmjet pjesëmarrjes në një numër veprimtarish në një mjedis stimulues, pozitiv dhe të sigurt.

- Të bashkëpunojë me familjet e fëmijëve, pushtetin vendor, OJF-të dhe subjekte juridike dhe private që veprojnë në fushën sociale.

Strategjia e institucionit në arritjen e objektivave bazohet në:

- Realizimi i shërbimeve sociale për fëmijët me probleme sociale. Rikthimi, atje ku është e mundur, i fëmijëve pranë familjeve biologjike.

- Zbatimi i legjislacionit në fuqi për birësimin e të miturve.

Në zbatim të "Konventës së të Drejtave të Fëmijëve" dhe kartës së "Të drejtave të njeriut", vë mbi gjithçka interesat e larta të fëmijëve.

- Organizimi i aktiviteteve brenda dhe jashtë institucionit me qëllim integrimin e fëmijëve me komunitetin.

- Bashkëpunimi me median e shkruar dhe elektronike për sensibilizimin e opinionit për kategorinë e fëmijëve që trajtohen në këtë institucion.

Për Kontrollin e Lartë të Shtetit, ky auditim ka një rëndësi të veçantë, për shkak të objektit kryesor që ky institucion ka, pasi puna e tij duhet të bazohet në vlerat e humanizmit, përkujdesit, respektit dhe përkushtimit ndaj fëmijëve.

- Për këtë janë vlerësuar aktivitetet që kanë të bëjnë me respektimin e kritereve mbi administrimin e shpenzimeve, buxhetimin dhe menaxhimin financiar, prokurimet publike, kontratat e miratuara, etj. Aktivitetet që do të jenë objekt vlerësimi nga grupi i auditimit, janë parashikuar sipas drejtimeve të miratuara nga Kryetari i KLSH-së, në programin e auditimit me nr. 694/1, datë 27.07.2022, i ndryshuar.

KLSH në periudhën nga data 01.08.2022 deri në 14.10.2022 për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2020 deri në 30.06.2022, kreu auditimin “Financiar dhe të Përputhshmërisë në Shtëpinë e Foshnjes “Lulet e Vogla” Korçë, me qëllim të një vlerësimi të përgjithshëm të përputhshmërisë së aktiviteteve të parashikuara në programin e auditimit me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

Grupi i auditimit të KLSH shqyrtoi, analizoi dhe arriti në konkluzione mbi secilën prej drejtimeve të auditimit, në bazë të dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, për të arritur në një siguri të arsyeshme në dhënien e konkluzioneve të auditimit.

Gjatë auditimit, janë mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manuali i auditimit të përputhshmërisë të KLSH, Rregullorja funksionimit organizativ dhe administrativ të KLSH, Rregullorja e procedurave të auditimit, Kodi i etikës, si dhe praktikat më të mira audituese të fushës.

Në arritjen e konkluzioneve dhe përfundimeve mbi përputhshmërinë e veprimtarisë institucionale me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës, krahas njohjes së detajuar të tyre të cilat kanë shërbyer si burim i kriterëve të auditimit, ne kemi përdorur metoda dhe teknika efikase si intervistime, raporte dhe informacione, verifikime, etj.

Gjetjet e këtij auditimi të karakterit organizativ, i janë nënshtruar skepticizmit profesional dhe gjykimit objektiv të audituesve, duke i dhënë mundësi KLSH në dhënien e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes, në funksion të rritjes së efektivitetit të veprimtarisë së institucioneve publike, transparencës, përgjegjësisë dhe llogaridhënies.

Shtëpia e Foshnjes ka një kapacitet prej 22 personash, aktualisht në këtë qendër marrin shërbim 6 rezidentë të cilët kanë statusin e “jetim social” dhe “biologjik”.

Rëndësia e këtij auditimi për KLSH është e përcaktuar nga pikëpamja shoqërore pasi ka të bëjë me çështje shumë sensitive të trajtimit të rezidentëve që marrin shërbim në këtë institucion, si edhe duke qenë se institucionet kanë probleme në drejtim të fondeve të akorduara të cilat nuk janë të mjaftueshme deri në plotësimin e nevojave të tyre dhe kushteve optimale të trajtimit, auditimi me efektivitet dhe ekonomikitet i fondeve del shumë i rëndësishëm.

Grupi i auditimit të KLSH shqyrtoi, analizoi dhe arriti në konkluzione mbi secilën prej drejtimeve të auditimit, në bazë të dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, për të arritur në një siguri të arsyeshme në dhënien e konkluzioneve të auditimit.

Gjatë gjithë procedurës së këtij auditimi, janë mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manuali i auditimit të përputhshmërisë të KLSH, Rregullorja funksionimit organizativ dhe administrativ të KLSH, Rregullorja e procedurave të auditimit, Kodi i etikës, si dhe praktikat më të mira audituese të fushës.

Në arritjen e konkluzioneve dhe përfundimeve mbi përputhshmërinë e veprimtarisë institucionale me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës, krahas njohjes së detajuar të tyre të cilat kanë shërbyer si burim i kriterëve të auditimit, ne kemi përdorur metoda dhe teknika efikase si intervistime, raporte dhe informacione, verifikime etj.

Gjetjet e këtij auditimi të karakterit organizativ, i janë nënshtruar skepticizmit profesional dhe gjykimit objektiv të audituesve, duke i dhënë mundësi KLSH në dhënien e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes, në funksion të rritjes së efektivitetit të veprimtarisë së institucioneve publike, transparencës, përgjegjësisë dhe llogaridhënies.

Raporti Përfundimtar i Auditimit është i strukturuar në pesë kapituj: përmbledhja ekzekutive; hyrja, me çështjet e objektivave dhe qëllimi i auditimit, përgjegjësitë e strukturave drejtuese dhe të audituesve, kriteret, identifikimi i çështjeve etj; përshkrimi i auditimit, në të cilin paraprin një informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar dhe vazhdon me trajtimin e rezultateve të auditimit për secilin prej drejtimeve të auditimit, gjetjet dhe rekomandimet dhe në fund anekset.

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA NË RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1	Nga krahasimi kërkesës buxhetore PBA 2019-2021 dhe buxhetit të miratuar për SHSSH, rezulton se plani i rishikuar në total 18,693 mijë lekë ka pësuar pakësim të shpenzimeve në shumën 139 mijë kundrejt planit fillestar. Sipas zërave buxhetor shpenzimet për paga janë pakësuar në shumën 498 mijë lekë, për sigurime shoqërore janë pakësuar në shumën 57 mijë lekë dhe shpenzimet për shërbime janë shtuar në shumën 416 mijë lekë. Buxheti i rishikuar i vitit 2020 rezulton me diferencë ndaj kërkesës buxhetore të institucionit në total në shumën 2,022 mijë lekë, dhe sipas zërave shpenzimet për paga janë miratuar më pak në shumën 933 mijë lekë, shpenzimet për sigurime janë miratuar më shumë në shumën 5 mijë lekë, shpenzimeve operative janë pakësuar më shumë së kërkesa buxhetore në shumën 1,094 mijë lekë. Për SHSSH PBA 2019-2021 nuk janë kërkuar shpenzime kapitale për vitin 2020, sepse këto kërkesa duhet të bëhen në Bashkinë Korçë. SHSSH prej vitesh nuk ka pranuar kërkesa për investime pasi këto investime do të bëhen nga pushteti lokal.	16-26	E mesme	-Shtëpia e Foshnjës “Lulet e jetës”, në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror dhe Bashkinë Korçë, përpara miratimit të VKM-së për çeljen e fondeve buxhetore, të vlerësojnë rëndësinë dhe prioritetin e kërkesës për zërin “Investime” në llogarinë 231, në funksion të shëndetit, sigurisë dhe mirëqenies së fëmijëve rezident në institucion.
2	Bashkisë Korçë i është transferuar e drejta e pronësisë së truallit dhe ndërtesës me nr. pasurie 3/62, ZK 8562, vol. 32, faqe 97, me sipërfaqe totale trualli 600 m² dhe sipërfaqe ndërtese 190 m², me VKM 336/2006, me qëllim	27-34	E lartë	-Bashkia Korçë (drejtoria e përgjithshme e pronës publike) të marrë masa për përgatitjen e formularit të

	vijimin e përdorimit të saj për të ushtruar veprimtarinë institucionale i shtëpisë së foshnjës. Pasuria sipërcituar është pajisur me akte kadastrale, përkatësisht certifikatë për vërtetim pronësie me nr. 235390, lëshuar më datë 25.05.2010. Edhe pse bashkisë Korçë i është transferuar e drejta e pronësisë, nuk rezulton të jetë marrë asnjë masë për përgatitjen dhe azhurnimin e formularit të inventarit të pronës (të vërtetimit dhe ndërtimit), në kundërshtim me pikën 21, VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar.			inventarit të pronës, si dhe azhurnimin e saj në vijim.
3	Godina ku ushtron veprimtarinë shtëpia e foshnjës “Lulet e vogla” është një ndërtim mbi 50 vjeçar. Bashkia Korçë (drejtoria e përgjithshme e pronës publike), në cilësinë e pronarit të pronës dhe shtëpia e foshnjës “Lulet e vogla”, në cilësinë e njësisë së varësisë që e përdor pronën, nuk rezultojnë të kenë ndërmarrë asnjë procedurë për kryerjen e aktekspertizës së thelluar të godinës, me qëllim vlerësimin e gjendjes teknike dhe kapacitetin e tij mbajtës, në kundërshtim me nenin 4/1, ligji nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.	27-34	E Lartë	-Bashkia Korçë (drejtoria e përgjithshme e pronës publike), të marrë masa për kryerjen e aktekspertizës së thelluar, me qëllim vlerësimin e gjendjes teknike të objektit dhe kapacitetet e tij mbajtëse.
5	Për periudhën objekt auditimi 2020-2022, nuk rezulton të ketë pasur inspektime nga Inspektoriati Shtetëror i Shëndetësisë, i cili e ka detyrë funksionale kontrollin e zbatimit të kriterëve e të kushteve nga subjektet publike që ushtrojnë veprimtari të ofrimit të shërbimeve shoqërore, në kundërshtim me nenin 35, ligji	27-34	E Lartë	-Inspektoriati Shtetëror i Shëndetësisë të marrë masa për të parashikuar në planin vjetor, kryerjen e inspektimeve në ambientin ku ushtron veprimtarinë shtëpia e foshnjës “Lulet e Vogla”.

	121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.			
6	Shtëpia e Foshnjës, është në proces pilotimi deri në fund të vitit 2022, me qëllim transformimin e shërbimit për të ofruar shërbime alternative referuar VKM nr.706, datë 09.09.2020 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit 2020-2022, dhe të Planit të Veprimit për zbatimin e tij”. Afati i zbatimit të Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit është drejt përfundimit. Nga auditimi i zbatimit të planit të deinstitutionalizimit dhe impaktit që ka pasur në Shtëpinë e Foshnjës “Lulet e Vogla”, Bashkia Korçë, janë konstatuar problematikat si: -Objektivat e përcaktuara në projektin e Bashkisë Korçë, miratuar nga MSHMS “Për ngritjen e shërbimeve mbështetëse për fëmijën dhe familjen” nuk janë arritur. Konkretisht, nuk është arritur parandalimi i ndarjes së fëmijëve nga prindërit, përfitimi i shërbimeve të specializuara dhe pilotimi i kujdesit alternativ profesional për fëmijët prindërit e të cilëve nuk mund të ushtrojnë kujdes prindëror për një kohë të caktuar. -Struktura e ngritur nga Bashkia Korçë, “Për Shërbimin dhe Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Familjes”, është angazhuar vetëm në parandalimin e institutionalizimit të fëmijëve dhe jo në deinstitutionalizimin e tyre që aktualisht ndodhen në qendrën rezidenciale. Fëmijët e qendrës rezidenciale Shtëpia e Foshnjës “Lulet e Vogla” janë larguar për arsye birësimi dhe për shkak të arritjes së moshës për transferimin	50-54	E Lartë	-Bashkia Korçë, në bashkëpunim me Shtëpinë e Foshnjës “Lulet e Vogla” Korçë dhe Shërbimin Social Shtetëror, të analizojnë ecurinë e procesit të pilotimit referuar Planit të Deinstitutionalizimit dhe nëpërmjet një raport progresi të evidentohen: sfidat dhe problematikat që janë hasur gjatë procesit të pilotimit për realizimin e objektivave, të vlerësohet efektiviteti i tij, sa i zbatueshëm dhe i arritshëm është brenda 5 viteve të ardhshme, në kushtet ekonomiko-sociale që ndodhet vendi. -Raport progresi i hartuar nga institucionet e Kujdesit Social, të dërgohet në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për të vlerësuar dhe marrë masat e nevojshme në lidhje me vënien në zbatim ose jo të Planit të Deinstitutionalizimit. -Bashkia Korçë, të evidentojë dhe vlerësojë familjet e gatshme për të qenë familje kujdestare me

në qendra rezidenciale të tjera për fëmijë të moshës nga 6-18 vjeç dhe jo se janë rikthyer në familje biologjike ose janë pozicionuar në familje kujdestare profesionale. -Në Bashkinë Korçë, mungon një listë e familjeve kujdestare pa lidhje gjaku. Ky fakt, bën të pamundur deinstitutionalizimin e fëmijëve të cilët nuk mund të kthehen në familjet biologjike apo në familje me lidhje gjaku. -Nga pushteti vendor dhe qendror nuk janë hartuar ende plane për transformimin e Shtëpisë së Foshnjës Korçë si institucion dhe si shërbimi si dhe nuk është bërë vlerësimi i kapacitetit të stafit. -Moratoriumi i vendosur për rastet e reja të fëmijëve që kanë nevojë përinstitutionalizim krijon një problem të ri ekonomiko-social i cili është ai i vështirësisë për ndjekjen e kujdestarisë së fëmijës nga familja biologjike si pasojë e institucionalizimit të këtyre fëmijëve në qytete të tjera të Shqipërisë. Për sa më lart, nuk është përmbushur procesi i deinstitutionalizimit në Bashkinë Korçë dhe as ai i transformimit të shërbimeve të ofruara nga Shtëpia e foshnjës “Lulet e Vogla”, për aq kohë sa këta fëmijë do të jenë përsëri objekt i politikave të deinstitutionalizimit në institucionet rezidenciale ku do të shkojnë, veprime në kundërshtim me VKM nr.706, datë 09.09.2020 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit 2020-2022, dhe të Planit të Veprimit për zbatimin e tij”.			qëllim që kjo Bashki, të ketë një listë zyrtare të këtyre familjeve. Në rast se familjet kujdestare nuk mund të evidentohen, të analizohen arsyet dhe ti bëhen me dije Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, pasi mungesa e një liste me familje kujdestare është pengesë për realizimin e planit të Deinstitutionalizimit. -Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Komitetin Drejtues të përpilojë dhe miratojë në kohë një plan për transformimin e institucioneve të përkujdesit rezidencial për fëmijë, duke vlerësuar proceset për bashkëpunimin me stafin e Shtëpisë Foshnjës “Lulet e Vogla” për ofrimin e shërbimeve alternative pasi të merret në analizë ecuria e planit dhe pilotimit deri në dhjetor 2022.
--	--	--	--

3. Opinioni i Auditimit

Opinion mbi pasqyrat financiare (i modifikuar/kualifikuar)

“Sipas opinionit tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, shprehim një opinion të **modifikuar/ kualifikuar** për llogaritë vjetore të subjektit Shtëpia e Foshnjës “Lulet e Vogla”, duke arritur në përfundimin se anomali të apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura, në llogaritë vjetore të vitit 2021”, të shprehura në bazën për opinion (trajtuar më poshtë).

Baza për kualifikimin e opinionit

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000- Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare- Udhëzues për SAI-n. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Problematikat ku ne jemi bazuar për dhënien e një opinionit të kualifikuar janë si më poshtë:

-Në pasqyrat e pozicionit dhe e performancës financiare të vitit 2021, regjistrimi i llogarive kontabël nuk është bërë referuar regjistrimeve në ditarët kontabël por veprimet ekonomike të rakorduara me Degën e Thesarit. Kështu, regjistrimi i të ardhurave dhe shpenzimeve nga personi përgjegjës për financën, nuk bëhet sipas destinacionit por sipas natyrës.

-Nga auditimi ka rezultuar regjistrim i gabuar i llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në llogarinë 4342 “Operacione me shtetit” në vlerën 138,853 lekë, ndërkohë që kjo vlerë nuk paraqitet në asnjë llogari në pasiv, pra nuk ka kundërparti të llogarisë në pasiv.

-Në pasqyrën e ndryshimeve të aktiveve neto/ fondeve neto, llogaria 101 “aktivet neto/fondet neto” nuk është ajo e vitit paraardhës, llogaria 105 “Nga grantet e brendshme kapitale” është pasqyruar në vlerën 0, si dhe nuk është pasqyruar fitimi i vitit ushtrimor. Fondet neto përfshijnë zëra si: teprica apo deficit i akumuluar, rezultatet e mbartura, rezultati i veprimtarisë ushtrimore, rezerva nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata, etj. Për rrjedhojë, mënyra e përlllogaritjes së “Fondit të akumuluar” në pasqyrën e pozicionit financiar nuk është e qartë.

-Në pasqyrën e pozicionit financiar për vitin ushtrimor nuk është pasqyruar llogaria 12 “Rezultatit të mbartur” e cila nga pikëpamja kontabël, në fillim të çdo viti ushtrimor, mbartet si rezultat i vitit ushtrimor të kaluar.

-Nga personi përgjegjës për hartimin e pasqyrave financiare nuk është hartuar regjistri i aktiveve dhe nuk mbahen llogaritë analitike të Aktiveve Afatgjata dhe Afatshkurtra së bashku me llogaritjen e amortizimit të tyre për çdo vit ushtrimor.

Opinion i auditimit mbi përputhshmërinë e pamodifikuar/pakualifikuar:

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Shtëpia e Foshnjës “Lulet e Vogla”, Korçë, me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor, rregullat, rregulloret dhe marrëveshjet që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të këtij institucioni.

“Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se veprimtaria e Shtëpia e Foshnjës “Lulet e Vogla”, Korçë është në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur justifikojnë dhënien e një opinionit të pakualifikuar”.

Baza për opinionin e pamodifikuar/pakualifikuar të përputhshmërisë.

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs)¹. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e transaksioneve. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, përfshirë marrjen në konsideratë të risqeve të mospërputhshmërisë materiale të transaksioneve me kriteret e parashikuara.

Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e *opinionit të pamodifikuar/pakualifikuar*.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 694/1, datë 27.07.2022, i ndryshuar, të miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 01.08.2022 deri në datë 14.10.2022, në subjektin Shtëpia e Foshnjes “Lulet e Vogla” Korçë, për periudhën nga data 01.01.2020 deri në datën 30.06.2022, u krye auditimi “Financiar dhe përputhshmërisë” nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. M.B, Përgjegjës Grupi
2. A.N, Auditues
3. E.T, Auditues
4. A.H, Auditues
5. G.P, Auditues
6. S.H, Auditues

1. Objekti i Auditimit

Objekti dhe fushëveprimi i auditimit është përputhshmëria (pajtueshmërisë) e operacioneve financiare të subjektit për periudhën nga 01.01.2020 deri më datë 30.06.2022.

Në objektivat dhe qëllimet e auditimit përfshihet vlerësimi objektiv i evidencave, dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, për të përcaktuar nëse të dhënat e raportuara për periudhën objekt auditimi përputhen me kriteret përkatëse të kuadrit rregullator.

Objekti i Auditimit është dhënia e opinionit nëse Shtëpia e Foshnjes “Lulet e Vogla” Korçë, në të gjithë aspektet materiale, aktiviteti ekonomik dhe financiar, transaksionet dhe informacioni janë në përputhje ose jo me dispozitat ligjore dhe rregulloret përkatëse, me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe kornizës ligjore të prokurimit publik, si dhe argumentimin e shpenzimeve të kryera në funksion të veprimtarisë së tij. Auditimi ka për qëllim promovimin e transparencës, duke ofruar raporte të besueshme për fondet nëse janë administruar, siç kërkohet në aktet ligjore.

Objektivat e auditimit synojnë:

a. Dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuara si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kriterëve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet, etj..

b. Aspektet e rregullshmërisë (respektimi i kriterëve formale siç janë ligjet përkatëse, rregulloret dhe marrëveshjet) dhe ligjshmërisë (respektimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë menaxhimin e shëndoshë financiar dhe sjelljen e zyrtarëve publik).

¹ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, ISSAI-n 4000 “Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”.

c. promovimin e një qeverisje të mirë, duke identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korrigjuese si dhe të identifikojë personat përgjegjës për veprimet e tyre.

Dhënien e vlerësimeve të pavarura mbi funksionimin e sistemeve dhe nënsistemeve të kontrollit të brendshëm dhe komponentëve të menaxhimit financiar të subjektit, nëpërmjet përcaktimit nga ana e audituesve:

- nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik.

- nëse të ardhurat dhe shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;

- verifikimin e përgjegjësisë financiare të subjekteve përgjegjëse, nëpërmjet ekzaminimit dhe vlerësimit të të dhënave financiare,

- auditimin e sistemeve financiare dhe transaksionet, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret.

2. Qëllimi i Auditimit

-Qëllimi i auditimit është hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimit të gjetjeve, si dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e shërbimit ndaj rezidentëve, rritjen e nivelit profesional të stafit që shërben, menaxhimi me efektivitet i fondeve në dispozicion, etj.

Me auditimin e përputhshmërisë, duhet të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi lidhur me realizimin e procedurave të prokurimit të realizuara në periudhën nën auditim.

Vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e raportuara janë në çdo aspekt material, në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë e Shtëpia e Foshnjës “Lulet e Vogla” Korçë. Qëllimi i auditimit: është dhënia e opinionit mbi rregullshmërinë dhe përputhshmërinë apo hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimet. Auditimi duke qenë pjesë jetike e një sistemi rregullator, *ka për qëllim* të vlerësojë dhe evidentojë shkeljet e parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndosh financiar si edhe shfrytëzimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomicitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike. Ky sistem bën të mundur ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese sipas rastit, rritjen e përgjegjshmërisë, llogari dhënies, rikuperimin e dëmeve të shkaktuara si dhe parandalimin e shkeljeve, me synim rritjen e vlerës së parasë publike në mbrojtje të interesave të taksapaguesve.

Qëllimi i këtij auditimi përputhshmërie është evidentimi i devijimit nga standardet e pranuar i shkeljes së parimeve të ligjshmërisë, është dhënia e opinionit apo hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimet të menaxhimit financiar me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga subjekti i audituar. Auditimi i përputhshmërisë i ndërmarrë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, ka për qëllim promovimin e qeverisjes së mirë në sektorin publik, duke marrë parasysh rrezikun e mashtimit në lidhje me përputhshmërinë (*sipas ISSAI 400, p 18*).

4. Identifikimi i çështjes: Institucioni duhet të ketë organizimin e duhur, për të funksionuar duke respektuar aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj fëmijëve rezidentë, duke patur në konsideratë shpenzimin e fondeve me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet. Projekt Raporti mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare të Shtëpisë së Foshnjës “Lulet e Vogla” Korçë, për periudhën 01.01.2020 - 30.06.2022, ka identifikuar sipas kriterëve specifikë të vlerësimit, shqyrtimin dhe vlerësimin e fushave në vijim:

- Hartimin, shqyrtimin dhe miratimin si dhe realizimin e buxhetit;

- Rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve;

- Mbajtjen e evidencës kontabile;

- Administrimin e pronës shtetërore;

- Zbatimin e ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave; etj.

5. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim: Strukturat drejtuese kanë për detyrë që të përgjigjen për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës. Një ndër përgjegjësitë kryesore të strukturave drejtuese është ngritja e sistemeve të kontrollit dhe marrjes së masave të sinjalizimit për veprime korruptive të punonjësve. Hartimi i rregullave të brendshme referuar funksionit të veprimtarisë së institucionit, strukturës në dispozicion, duke përcaktuar përgjegjësitë dhe detyrimet e çdo punonjësinë zbatim të akteve ligjore në fuqi, mbi të gjitha duke shmangur dhe mbikëqyrur konfliktin e interesit. Përgjegjësi e strukturave drejtuese të institucionit është përdorimi me efektivitet dhe ligjor të fondeve, duke eliminuar shpenzimet jo efektive dhe jo në funksion të veprimtarisë, sigurisht dhe marrja e masave për njohjen e akteve ligjore në fuqi që veprojnë dhe për të gjithë punonjësit e strukturës funksionale duke programuar trajnimin e vazhdueshëm dhe mbikëqyrur integritetin e tyre.

Institucioni brenda kuadrit përkatës të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, kryen çdo operacion financiar që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e tij.

6. Përgjegjësitë e audituesve: Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion të saktë objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen ose jo, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuar mbi përputhshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë ekonomiko financiare, në bazë të auditimit tonë.

Ne mbajmë përgjegjësi që në praktikën e auditimit si dhe në hartimin e P/Raportit të auditimit janë zbatuar procedurat në përputhje me rregulloret e miratuara dhe në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI. Referuar këtyre Standardeve audituesi gjithashtu duhet të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim që të arrijë nivelin e sigurisë së kërkuar. Siguria e kërkuar i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute, dhe auditimi në pajtueshmëri me standardet nuk presupozohet që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtimit apo gabimit.

7. Kriteret e vlerësimit: Kriteret e vlerësimit të përdorura në këtë auditim e kanë burimin në legjislacionin bazë dhe dytësor, në dispozita të tjera si dhe kuadrin rregullator përkatës sipas çështjeve të auditimit: Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar; Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Ligji nr. 7892, datë 21.12.1994 “Për Sponsorizimet”, i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 10347, datë 04.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve”, i ndryshuar me Ligj nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, Ligj nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i ndryshuar, Ligj nr. 22/2018, datë 03.05.2018 “Për strehimin social”, Ligj nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në RSH”, VKM nr. 658, datë 17.10.2005 “Për standartet e shërbimeve shoqërore”, VKM nr. 425, datë 27.06.2012 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale, publike dhe private të përkujdesit social”, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar; rregulloren e institucionit, etj.

8. Standardet e auditimit: Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranura të kuadrit ligjor, rregullator dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit. Projekt Raporti i auditimit është hartuar në përputhje me kërkesat e Rregullores së Procedurave të Auditimit në KLSH, mbështetur në:

-Ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

- ISSAI 100 – *(Parimet themelore të auditimit të sektorit publik)*.
 - ISSAI 400 – *(Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë)*.
 - ISSAI 4100 - *(Rregulloren e Procedurave të Auditimit)*.
 - Kodi etik i KLSH dhe Rregullorja e Brendshme.
 - ISSAI 4000-Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”;
 - ISSAI 1500 (ISA 500)
 - Objektivi i audituesit është të hartojë dhe të kryejë procedurat e auditimit në mënyrë të tillë që të mundësojë marrjen e evidencës së mjaftueshme për të nxjerrë konkluzione të arsyeshme në të cilin do të bazojë opinionin e tij;
 - Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve;
 - Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”; si dhe në praktikën më të mira të fushës.
- 9. Metodatat e auditimit,** Audituesit e KLSH, mbi bazën e evidencave të kërkuaradhe të vëna në dispozicion, intervistave, takimeve dhe konsultave me nëpunësit e Bashkisë dhe Shtëpisë së Foshnjës “Lulet e Vogla” Korçë, kanë përgatitur dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kriterëve të përdorura, të fushë-veprimit të auditimit; të gjykimeve, të përfundimeve të arritura, programin dhe natyrën e auditimit, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera; si dhe konkluzioneve lidhur me to. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, pyetësorëve, të finalizuara me akt-konstatimet dhe observacionet e subjektit, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij Projekt-Raporti.
- 10. Dokumentimi i auditimit,** është kryer bazuar në kërkesat e manualit të auditimit të përputhshmërisë, në standardet ndërkombëtare të auditimit (ISAI), për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin

Në Shqipëri funksionon një rrjet institucionesh të përkujdesit shoqëror (IPSH), të cilat ofrojnë shërbime për kategoritë në nevojë. IPSH-të publike financohen nga shteti nëpërmjet Shërbimit Social Shtetëror ose Bashkive dhe menaxhohen në nivel qendror dhe lokal.

Shtëpia e Foshnjës Korçë është institucion shtetëror rezidencial nën varësinë e Bashkisë Korçë. Ky institucion e zhvillon veprimtarinë e tij në bazë të Ligjit Nr.9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore dhe akteve nënligjore në zbatim të tij si dhe në përputhje me Konventën “ Mbi të drejtat e fëmijës” dhe kartën e “Të drejtave të njeriut”.

Shtëpia e Foshnjës “Lulet e Vogla” Korçë, ofron shërbim rezidencial të përkujdesit shoqëror për fëmijët në nevojë dhe është në varësi të Shërbimit Social Shtetëror dhe Bashkisë Korçë.

Misioni i Shtëpisë së Foshnjës është zbatimi dhe zbërthimi i strategjive dhe politikave, në përputhje me programin politik të Qeverisë dhe SHSSH zbatimi i legjislacionit në fuqi dhe kërkesave që parashtrihen në standartet kombëtare, që si parim bazë kanë interesin e lartë të fëmijës, për mirërritjen, kujdesin shëndetësor dhe social për fëmijët me probleme sociale. Ajo krijon kushtet dhe karakteristikat e një ambienti familjar, integrimin e fëmijëve në ambientet jashtë institucionit, vendosjen e fëmijëve në mjedise familjare me përparësi atë të origjinës.

Shtëpia ka si qëllim mirërritjen, kujdesin shëndetësor dhe social për fëmijet, edukimin, arsimimin dhe trajtimin psiko-social të fëmijëve. Ai krijon për fëmijet kushtet dhe karakteristikat e një ambienti familjar, integrimin e tyre në ambientin jashtë institucionit, vendosjen e fëmijëve në mjedis familjar, me përparësi atë të origjinës. Objektivat e institucionit janë:

-Të ofrojë një mjedis të sigurt dhe mbështetës për fëmijët me probleme sociale. Fëmijë me probleme sociale janë fëmijët e braktisur, fëmijët e familjeve shumë të varfëra, fëmijët me prindër të divorcuar, fëmijë të prindërve të cilëve u është hequr e drejta prindërore.

-Të hartojë programe individuale kujdesi për fëmijët që ata të kenë mundësi të zhvillojnë shprehitë e tyre dhe të maksimalizojnë potencialin nëpërmjet pjesëmarrjes në një numër veprimtarish në një mjedis stimulues, pozitiv dhe të sigurt.

-Të bashkëpunojë me familjet e fëmijëve, pushtetin vendor, OJF-të dhe subjekte juridike dhe private që veprojnë në fushën sociale.

Strategjia e institucionit në arritjen e objektivave bazohet në:

- Realizimi i shërbimeve sociale për fëmijët me probleme sociale. Rikthimi, atje ku është e mundur, i fëmijëve pranë familjeve biologjike.

- Zbatimi i legjislacionit në fuqi për birësimin e të miturve.

Në zbatim të "Konventës së të Drejtave të Fëmijëve" dhe kartësë "Të drejtave të njeriut", vë mbi gjithçka interesat e lartatë fëmijëve.

-Organizimi i aktiviteteve brenda dhe jashtë institucionit me qëllim integrimin e fëmijëve me komunitetin.

-Bashkëpunimi me median e shkruar dhe elektronike për sensibilizimin e opinionit për kategorinë e fëmijëve që trajtohen në këtë institucion.

Për Kontrollin e Lartë të Shtetit, ky auditim ka një rëndësi të veçantë, për shkak të objektit kryesor që ky institucion ka, pasi puna e tij duhet të bazohet në vlerat e humanizmit, përkujdesit, respektit dhe përkushtimit ndaj fëmijëve.

-Për këtë janë vlerësuar aktivitetet që kanë të bëjnë me respektimin e kriterëve mbi administrimin e shpenzimeve, buxhetimin dhe menaxhimin financiar, prokurimet publike, kontratat e miratuara, etj. Aktivitetet që do të jenë objekt vlerësimi nga grupi i auditimit, janë parashikuar sipas drejtimeve të miratuara nga Kryetari i KLSH-së, në programin e auditimit me nr. 694/1, datë 27.07.2022, i ndryshuar.

KLSH në periudhën nga data 01.08.2022 deri në 14.10.2022 për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2020 deri në 30.06.2022, kreu auditimin "Financiar dhe të Përputhshmërisë në Shtëpinë e Foshnjes "Lulet e Vogla" Korçë, me qëllim të një vlerësimi të përgjithshëm të përputhshmërisë së aktiviteteve të parashikuara në programin e auditimit me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

Grupi i auditimit të KLSH shqyrtoi, analizoi dhe arriti në konkluzione mbi secilën prej drejtimeve të auditimit, në bazë të dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, për të arritur në një siguri të arsyeshme në dhënien e konkluzioneve të auditimit.

Gjatë auditimit, janë mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manuali i auditimit të përputhshmërisë të KLSH, Rregullorja funksionimit organizativ dhe administrativ të KLSH, Rregullorja e procedurave të auditimit, Kodi i etikës, si dhe praktikat më të mira audituese të fushës.

Në arritjen e konkluzioneve dhe përfundimeve mbi përputhshmërinë e veprimtarisë institucionale me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës, krahas njohjes së detajuar të tyre të cilat kanë shërbyer si burim i kriterëve të auditimit, ne kemi përdorur metoda dhe teknika efikase si intervistime, raporte dhe informacione, verifikime, etj.

Gjetjet e këtij auditimi të karakterit organizativ, i janë nënshtruar skepticizmit profesional dhe gjykimit objektiv të audituesve, duke i dhënë mundësi KLSH në dhënien e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes, në funksion të rritjes së efektivitetit të veprimtarisë së institucioneve publike, transparencës, përgjegjësisë dhe llogaridhënies.

Shtëpia e Foshnjes ka një kapacitet prej 22 personash, aktualisht në këtë qendër marrin shërbim 6 rezidentë të cilët kanë statusin e "jetim social" dhe "biologjik".

2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit:

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përfundim të procesit të auditimit për secilin drejtim të Auditimit, rezultoi sa më poshtë vijon:

1. Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit.

Në zbatim të pikës 1, të programit të auditimit “nr.694/1 datë 27.07.2022”, i ndryshuar, lidhur me zbatimin e kriterëve në planifikimin e buxhetit sipas ligjeve dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, ligjet vjetore “Për buxhetin e shtetit” të vitit 2020, 2021 dhe 2022, si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit.

U shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Rregullorja e brendshme e Shtëpisë së Foshnjes.
- Akte të tjera ligjore dhe nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e institucionit.
- Dokumentacioni i PBA-ve të miratuara gjatë periudhës objekt auditimi.
- Buxheti i miratuar dhe ndryshimet e kryera gjatë vitit
- Realizimi i shpenzimeve me planifikimet.
- Zbatimi i kriterëve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:

a) Zbatimi i kriterëve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në Udhëzimet e Ministrisë së Financave mbi hartimin e buxhetit të shtetit.

Kërkesa buxhetore sipas PBA 2019-2021, në mbështetje të nr. Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimit të e Ministrisë së Financave 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, Shtëpia e Foshnjes “Lulet e Vogla” me shkresën nr. 207/1 prot, datë 19.06.2018 ka dërguar në Drejtorinë e Financave në SHSSH Pasqyrat e PBA 2019-2021, Relacionin për PBA, Formularët e Projekt Investimeve 2019-2021, hartuar nga Komisioni i hartimit të PBA 2019-2021 (pa urdhër te NA).

-Kërkesa buxhetore sipas PBA 2020-2021, në mbështetje të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimit të e Ministrisë së Financave nr.8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 28.02.2012 “Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm” Shtëpia e Foshnjes “Lulet e Vogla” me shkresën nr. 195/1 prot, datë 27.06.2019 ka dërguar në Drejtorinë e Financave në SHSSH Pasqyrat e PBA 2019-2021 së bashku me relacionin përkatës dhe Formularët e Projekt Investimeve 2019-2021, hartuar nga Komisioni i Hartimit të PBA 2019-2021, ngritur me Urdhër të Drejtorit nr. 28, datë 09.07.2019. Planifikimi i fondeve sipas PBA 2020-2022 në mënyrë të përmbledhur paraqitet si më poshtë:

-Kërkesa buxhetore sipas PBA 2021-2023, në mbështetje të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 10, datë 28.02.2017 “Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023” Shtëpia e Foshnjes “Lulet e Vogla” me shkresën (dërguar me email dt. 30.06.2020) dhe shkresën nr. 110 prot, datë 26.06.2019 ka dërguar në Drejtorinë e Financave në SHSSH Pasqyrat e PBA 2019-2021 së bashku me relacionin përkatës dhe Formularët e Projekt Investimeve 2019-2021, hartuar nga Komisioni i Hartimit të PBA 2019-2021.

Planifikimi i fondeve sipas PBA 2019-2021; PBA 2020-2022; PBA 2021-2023 në mënyrë të përmblendhur paraqitet si më poshtë:

Kërkesa buxhetore sipas PBA 2019-2021 (në mijë lekë)

Emërtimi	Kërkesa PBA 2019-2021	Kërkesa PBA 2020-2022	Kërkesa PBA 2021-2023
-Paga	12,944	17,950	12,947
-Sigurime shoqërore & shëndetësore	2,161	2,997	2,195
-Shërbime	5,610	6,190	5,700
Shp. Operative (A)	20,715	27,137	20,842
-Investime	250	120	
Shpenzime kapitale (B)	250		
II. Total shpenzime (A)+(B)	20,965	27,257	20,842
Numri punonjësve	22	22	22

Burimi: SHF

Parashikimi i “**shpenzimeve për personelin**” përfshin pagat bruto për punonjësit e përhershëm dhe të përkohshëm, shtesat mujore mbi pagë si orët për turnet e dyta dhe të treta. Përveç shpenzimeve për paga, parashikohen edhe shpenzimet e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të cilat janë planifikuar në masën 16.7% të nivelit të bazës së pagës bruto.

Parashikimi i shpenzimeve “**për mallra dhe shërbime**” është zë i rëndësishëm në funksionimin e këtij institucioni dhe përfshin:

-zërin “materiale dhe shërbime të përgjithshme” ku parashikohen shpenzime për kancelari, materiale pastrimi, blerje dokumentacioni, blerje detergjente, etj. Shërbime speciale janë parashikuar blerje për veshje për fëmijë, medikamente, Ushqime.

-zërin “shërbime” për shërbimet që realizohen nga të tretët si energji elektrike, shpenzim për ngrohje, posta, telefon, etj.

-zërin “shpenzime transporti” janë parashikuar shpenzime për blerje karburanti për kaldajën dhe për mjetin e transportit.

-Shpenzime “të tjera operative” janë parashikuar shpenzimet për pagesën e taksave vendore.

Parashikimi i “**shpenzimeve kapitale**”, parashikon shpenzimet që do të kryhen për krijimin ose blerjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe patrupëzuara, të cilat parashikojnë realizimin për ndërtimin e një investimi shtesë kati për ambjentet e shtëpisë së fëmijës dhe blerje kompjutera. Burimi kryesor i të ardhurave për funksionimin e institucionit është buxheti i shtetit dhe Bashkia Korçë. Gjatë hartimit të projekt buxhetit kërkesa buxhetore në PBA 2020-2022 krahasuar me PBA 2019-2021, është rritur në shumën 6,292 mijë lekë ose 19.9%, ndërsa kërkesa buxhetore PBA 2021-2023 krahasuar me PBA 2020-2022 është ulur në shumën 6,415 mijë lekë ose me pak 23.3%.

b) Zbatimi i kriterëve në çeljen e buxhetit sipas viteve, drejtimi i planit fillestar, transferimin e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore si dhe planin përfundimtar.

Viti 2020, Detajimi i limitit mujor të fondeve të njësie shpenzuese është bërë mbështetur në ligjin nr. 99, datë 03.12.2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat

standard të zbatimit të buxhetit”, UMF nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit”, UMF nr. 1 datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020”.

Buxheti i vitit 2020 krahasuar me kërkesat sipas PBA 2019-2021

(ne mijë leke)

Emërtimi	Kërkesa PBA 2019-2021	Plani fillestar	Plani rishikuar Mars	Plani rishikuar Gusht	Plani rishikuar Nëntor	Ndryshimi (Plani Rishikuar/ Plani Fillestar)	Ndryshimi (Plani Rishikuar/ Kërkesë Buxhetore)
Shpenzime (A)+(B)							
Paga	12,944	12,509	12,509	11,717	12,011	(498)	(933)
Sigurime	2,161	2,223	2,223	2,091	2,166	(57)	5
Shërbime	5,610	4,100	4,166	4,166	4,516	416	(1,094)
TotalShp. Operative (A)	18,832	18,898	17,717	12,011	18,693	(139)	(2,022)
Investime	250	250	511	511	261	(11)	(11)
Shpenzime kapitale Total (B)	250	250	511	511	261	(271)	(271)
Numri punonjësve total	22	18		18	18	0	(4)
-Me kontrate te përhershme	21	17		17	17	0	(4)
-Me kohe te pjesshme	1	1		1	1	0	0

Burimi:SHF

Me shkresën nr. 238/1 prot, datë 21.01.2020, SHSSH ka dërguar buxhetin e vitit 2020 në limite vjetore dhe mujor në shumën vjetore 14,037 mijë lekë dhe numrin e punonjësve me kontrate gjithsej 14 punonjës. Plani fillestar ka ndryshuar me shkresa të SHSSH:

- nr. 80/81 prot, datë 03.08.2020, protokolluar më nr. 122, datë 07.08.2020 duke shtuar shpenzimet për paga në shumën 1500 mijë lekë dhe 250 mijë sigurime shoqërore;

- nr. 80/87 dt. 28.08.2020, protokolluar me nr. 125, dt.31.08.2020, duke shtuar shpenzimet për shërbime në shumën 500 mijë lekë;

- nr. 80/116, datë 25.11.2020, protokolluar më nr. 184, dt. 26.11.2020 duke pakësuar shpenzimet për paga në shumën 165 mijë lekë;

Me shkresën email datë 06.01.2020, Bashkia Korçë ka dërguar buxhetin e vitit 2020 në limit vjetore dhe mujor në shumën vjetore 4995 mijë lekë (paga 3852 mijë lekë, sigurime shoqërore 643 mijë lekë, shërbime 500 mijë lekë dhe investime 250 mijë lekë) dhe numrin e punonjësve gjithsej 7 punonjës, investime 250 mijë lekë .

Plani fillestar ka ndryshuar sipas shkresave të Bashkisë Korçë:

-Urdhër kryetari Bashkia Korçë nr. 2133 prot, datë 05.03.2020 duke shtuar shpenzimet për shërbime nga sponsorizimet në shumën 46 mijë lekë;

-Urdhër kryetari Bashkia Korçë nr. 2134 prot, datë 05.03.2020 duke shtuar shpenzimet për investime nga sponsorizimet në shumën 261.2 mijë lekë

-Kërkesë Buxhetore nr.12, datë 25.03.2020 duke shtuar shpenzimet për shërbime nga sponsorizimet në shumën 20 mijë lekë;

-Urdhër kryetari Bashkisë Korçë nr.84 prot, datë 30.07.2020 duke pakësuar shpenzimet për paga 2292 mijë lekë, sigurime shoqërore 382 mijë lekë;

-Urdhër Kryetari Bashkisë Korçë nr.63, datë 12.11.2020 dhe nr.70 prot, datë 14.12.2020 sipas kërkesës buxhetore të bërë duke shtuar shpenzimet për paga 458 mijë lekë, sigurime shoqërore 75 mijë lekë dhe pakësuar shpenzimet për shërbime për 150 mijë lekë;

Buxheti i akorduar nga SHSSH për vitin 2020 në shumën 15,922 mijë lekë dhe Bashkia Korçë për vitin 2020 në shumën 2,771 mijë lekë rakordon me situacionet mujore/progresive të shpenzimeve dhe evidencën mujore/progresive shpenzimeve të firmosur nga Dega e Thesarit Korçë me vlerën totale prej 18,693 mijë lekë.

Konkluzion: Nga krahasimi kërkesës buxhetore PBA 2019-2021 dhe buxhetit të miratuar për SHSSH, rezulton se plani i rishikuar në total 18,693 mijë lekë ka pësuar pakësim të shpenzimeve

ne shumën 139 mijë kundrejt planit fillestar. Sipas zërave buxhetor shpenzimet për paga janë pakësuar në shumën 498 mijë lekë, për sigurime shoqërore janë pakësuar në shumën 57 mijë lekë dhe shpenzimet për shërbime janë shtuar në shumën 416 mijë lekë. Buxheti i rishikuar i vitit 2020 rezulton me diferencë ndaj kërkesës buxhetore të institucionit në total në shumën 2,022 mijë lekë, dhe sipas zërave shpenzimet për paga janë miratuar më pak në shumën 933 mijë lekë, shpenzimet për sigurime janë miratuar më shumë në shumën 5 mijë lekë, shpenzimeve operative janë pakësuar më shumë së kërkesa buxhetore në shumën 1,094 mijë lekë.

Për SHSSH PBA 2019-2021 nuk janë kërkuar shpenzime kapitale për vitin 2020, sepse këto kërkesa duhet të bëhen në Bashkinë Korçë. SHSSH prej vitesh nuk ka pranuar kërkesa për investime pasi këto investime do të bëhen nga pushteti lokal.

Bashkia Korçë, ka planifikuar një fond prej 250 mijë lekë dhe çeli gjatë vitit edhe një fond prej 261 mijë lekë, për ndërtim objekti (shtesë kati). Blerja e kompjuterave është realizuar në vlerën 240 mijë lekë por fondet u trashëguan për vitin 2021 njësisë shpenzuese. Vlera e fondeve për ndërtim u trashëgua për vitin 2021.

Viti 2021, Detajimi i limitit mujor të fondeve të njësie shpenzues është bërë mbështetur në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit”, Ligjit 88/2019 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2020, ”UMF nr. 4 datë 25.01.2021 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021”.

Buxheti i vitit 2021 krahasuar me kërkesat sipas PBA 2021-2023 (ne mije leke)

Emërtimi	Kërkesa PBA 2021-2023	Plani fillestar i miratuar janar 2021	Plani rishikuar gusht 2021	Plani rishikuar nëntor 2021	Plani rishikuar dhjetor 2021	Ndryshim i Plani rishikuar/ Planit Fillestar	Ndryshim i Plani rishikuar/ Kërkesë Buxhetore
Shpenzime (A)+(B)							
Paga	17,950	13,752	13,752	13,952	12,026	(1,726)	(5,924)
Sigurime	2,997	2,334	2,334	2,468	2,367	33	(630)
Shërbime	6,190	4,100	4,713	5,213	5,213	1113	(977)
Transferta							
Shp. Operative (A)	27,137	20,186	20,799	21,633	19,606	(580)	(7,531)
Investime	120	120	621	621	501	(261)	(261)
Shpenzime kapitale (B)	120	142	621	621	501	(120)	(120)

Burimi: SHF

SHSSH me shkresën nr. 125/1 prot, datë 27.01.2021 ka dërguar plan buxhetin e vitit 2021 në limit vjetor dhe mujor në shumën vjetore 15,190 mijë lekë gjithsej dhe nr i punonjësve 14 dhe 1 me kontratë. Plani fillestar ka ndryshuar me shkresa të SHSSH:

- nr. 1279/1 prot, datë 28.06.2021, protokolluar me nr. s'ka, duke shtuar shpenzimet operative në shumën 500 mijë lekë.

- nr. 333/62 prot, datë 05.10.2021, protokolluar me nr. s'ka, duke pakësuar shpenzimet për paga në shumën 20 mijë lekë, sigurime shoqërore 34 mijë lekë dhe shpenzime operative 500 mijë lekë. Me shkresën nr193. prot, datë 11.01.2021, Bashkia Korçë ka dërguar buxhetin e vitit 2021 në limit vjetor dhe mujor në shumën vjetore 4,996 mijë lekë (paga 3852 mijë lekë, sigurime shoqërore 643 mijë lekë, shërbime 500 mijë lekë dhe investime 250 mijë lekë për likuidimin e pagesës të kompjuterave të blerë në vitin 2020), investime në vlerën 120 mijë lekë për sistemin e fikjes së

zjarrit dhe numrin e punonjësve gjithsej 7 punonjës. Plani fillestar ka ndryshuar sipas me shkresë të Bashkisë Korçë:

-Urdhër kryetari Bashkia Korçë nr.1838 prot, datë 10.02.2021 duke shtuar shpenzimet për investime nga sponsorizimet në shumën 261,2 mijë lekë, duke shtuar shpenzimet për shërbime nga sponsorizimet në shumën 113 mijë lekë;

-Urdhër kryetari Bashkia Korçë nr. 72 prot, datë 09.11.2021 dhjetor duke pakësuar shpenzimet për paga me 1,926 mijë lekë dhe sigurimet shoqërore me 321 mijë lekë si dhe fondin për investime në 120 mijë lekë.

Buxheti i akorduar nga SHSSH dhe Bashkia Korçë për vitin 2021 është në shumën 19,285 mijë lekë, e cila rakordon me situacionet mujore/progresive të shpenzimeve dhe evidencën mujore/progresive të shpenzimeve të firmosur nga Dega e Thesarit Korçë, 16,424 mijë lekë Buxheti i Shtetit dhe 2,861 mijë lekë Bashkia Korçë.

Viti 2022, Detajimi i limitit mujor të fondeve të njësisë shpenzues është bërë mbështetur në ligjin nr. 9936, datë 03.12.2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, Ligjit nr. 88/2019 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2020”, UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit”, UMF nr. 1 datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”.

Buxheti i vitit 2022 krahasuar me kërkesat sipas PBA 2020-2022						(ne mije leke)	
Emërtimi	Kërkesa PBA 2020-2022	Plani fillestar i miratuar	Plani rishikuar shkurt 2022	Plani rishikuar Prill 2022	Plani rishikuar Qershor 2022	Ndryshimi (Plani rishikuar/ Planit Fillestar)	Ndryshimi (Plani rishikuar/ Kërkesë Buxhetore)
Shpenzime (A)+(B)		21,715	21,535	21,075	21,075		
Paga	12,497	13,769	13,769	13,769	13,769		
Sigurime	2,195	2,306	2,306	2,306	2,306		
Shërbime	5,700	5,100	5,199	4,739	4,739		
Transferta	0	0	0	-	-		-
Shp.Operative (A)		21,715	21,274	20,814	20,814		
Investime		0	261	261	261		
Shpenzime kapitale (B)		0	0	0	0	0	

Burimi: SHF

SHSSH me shkresën nr. 64/1 prot, datë 18.01.2022 ka dërguar plan buxhetin e vitit 2022 në limit vjetor dhe mujor në shumën vjetore 16,160 mijë lekë.

Plani fillestar ka ndryshuar me shkresë të SHSSH:

- nr.69/30, datë 19.04.2022, duke pakësuar shpenzimet për shërbime në shumën 460 mijë lekë.

Buxheti i akorduar nga Bashkia Korçë për vitin 2022 në shumën 5,015 mijë lekë rakordon me situacionet mujore/progresive të shpenzimeve dhe evidencën mujore/progresive shpenzimeve të firmosur nga Dega e Thesarit Tiranë.

Nga krahasimi i kërkesës buxhetore PBA 2021-2023 dhe buxhetit të miratuar për SHSSH, rezulton se plani i rishikuar kundrejt planit fillestar ka miratuar më shumë shpenzime ka ndryshuar për - 460 mijë lekë. Sipas zërave shpenzimet për paga janë miratuar më shumë në shumën +1,272 mijë lekë, shpenzimet për sigurime shoqërore në shumën +111 mijë lekë. PBA 2021-2023 nuk ka miratuar shpenzime kapitale për vitin 2022, sipas kërkesës së njësisë shpenzuese.

Konkluzion: Nga krahasimi kërkesës buxhetore PBA 2021-2023 dhe buxhetit të miratuar, rezulton se buxheti i rishikuar në vitin 2021 në total 19,606 mijë krahasuar me planin fillestar ka pësuar pakësim shpenzimesh në shumën 580 mijë lekë. Zërat buxhetorë të vitit 2021, kanë pësuar ndryshim kundrejt buxhetit fillestar për paga më shumë në shumën 1,726 mijë lekë dhe shpenzime për sigurime në shumën 33 mijë lekë dhe shërbime për 1,113mijë lekë.

Buxheti i miratuar i vitit 2021 rezulton me diferencë ndaj kërkesës buxhetore në total për më pak në shumën -7,531 mijë lekë, nga të cilat shpenzimet për paga janë miratuar më pak në shumën -5,924 mijë lekë, shpenzimet për sigurime më pak në shumën -630 mijë lekë dhe shpenzimeve shërbime më pak në shumën -977 mijë lekë.

Përsa i përket shpenzimeve kapitale për SHSSH nuk janë kërkuarshpenzime kapitale për vitin 2021, sipas kërkesës së njësisë shpenzuese, Bashkia Korçë ka miratuar fondin e kërkuar për 120 mijë lekë për sistemin zjarrfikës i cili nuk u realizua për situatën e krijuar pas procedurës të deinstitutionalizimit.

c) Realizimi i planit të buxhetit.

Viti 2020, Realizimi i buxhetit të SHSSH për vitin 2020, krahasuar me kërkesat e vitit 2020, të përcjella nga institucioni sipas dokumentit të PBA 2019-2021, alokimit fillestar të buxhetit dhe atij të ndryshuar paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Realizimi i buxhetit të vitit 2020 (ne mije leke)

Emërtimi		Kërkesa PBA 2019- 2021	Plani fillestar	Plani rishikuar Nëntor 2020	Realizmi 2020	Realizmi 2020(%)
II Shpenzime (A)+(B)		21,215	19,082	19,204	18,374	96.3
Shp.Operative (A)	Paga	12,944	12,509	12,011	11,924	99.3
	Sigurime	2,161	2,223	2,166	1,990	92
	Shërbime	5,610	4,100	4,516	4,460	98.8
	Transferta					
Total (A)		20,965	18,832	18,693	18,374	98.3
Shpenzime kapitale (B)	Investime	250	250	511	0	0
Total (B)		250	250	511	0	0

Burimi: SHF

Sipas PBA 2019-2021 të SHSSH, **për vitin 2020** në total janë kërkuar 21,215 mijë lekë, nga të cilat fillimisht janë alokuar 19,082 mijë lekë dhe sipas buxhetit të rishikuar përfundimtar janë alokuar 18,374 mijë lekë. Realizimi shpenzimeve buxhetore në **vlerën 18,374 mijë lekë**, ose me një përqindje realizimi prej **99.03%**. Shpenzimet për sigurimet shoqërore janë planifikuar më shumë dhe dalin me mosrealizim por në fakt janë likuiduar 16.7 % të fondit të pagave.

Për **shpenzimet operative**, ku sipas PBA 2019-2021 janë kërkuar prej 5610 mijë lekë, nga të cilat fillimisht janë alokuar 4,100 mijë lekë dhe sipas buxhetit të rishikuar 4,516 mijë lekë. Për vitin 2020 struktura e shpenzimeve përbëhet nga shpenzime për paga 64.9%, shpenzimet për sigurime shoqërore 10.83% dhe shpenzimet për shërbime që zënë 24.27% të shpenzimeve korrente të vitit buxhetor.

Viti 2021, Realizimi i buxhetit të SHSSH për vitin 2019, krahasuar me kërkesat e vitit 2020, të përcjella nga institucioni sipas dokumentit të PBA 2020-2022, alokimit fillestar të buxhetit dhe atij të ndryshuar paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Realizimi i buxhetit të vitit 2021

(ne mije leke)

Emërtimi		Kërkesa PBA 2020- 2022	Plani fillestar	Plani rishikuar Nëntor 2021	Realizm i 2021	Realizm i %
Shpenzime (A)+(B)		27,377	20,306	19,786	18,510	93.55
Shp.Operative (A)	Paga	17,950	13,752	12,026	11,549	96.03

	Sigurime	2,997	2,334	2,368	1,928	81.4
	Shërbime	6,190	4,100	5,213	4,793	91.94
	Transferta					
Total (A)		27,257	20,186	19,607	18,270	94.73
Shpenzime kapitale (B)	Investime	120	120	501	240	47.9
Total (B)		120	120	501	240	47.9

Burimi: SHF

Në total për vitin 2020, ku sipas PBA 2020-2023, nga SHSSH janë kërkuar 27,377 mijë lekë, nga të cilat fillimisht janë alokuar 20,306 mijë lekë dhe sipas buxhetit të rishikuar përfundimtar **19,786 mijë lekë**. Realizimi shpenzimeve nga institucioni rezulton në vlerën **18,510 mijë lekë**, ose realizuar në masën 93.55%.

Shpenzimet operative janë kërkuar 27,257 mijë lekë, nga të cilat fillimisht janë alokuar 20,186 mijë lekë dhe sipas buxhetit të rishikuar realizuar 94.73 %.

Për vitin 2021 struktura e shpenzimeve përbëhet nga shpenzime për paga 63.21%, shpenzimet për sigurime shoqërore 10.55% dhe shpenzimet për shërbime zënë 26.24% të shpenzimeve korrente te vitit buxhetor.

Viti 2022, Realizimi i buxhetit të SHSSH për vitin 2021, krahasuar me kërkesat e vitit 2021, të përcjella nga institucioni sipas dokumentit të PBA 2021-2023, alokimit fillestar të buxhetit dhe atij të ndryshuar paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Realizimi i buxhetit 6 mujori 2022(Ne mijë lekë)

Emërtimi		Kërkesa PBA 2021-2023	Plani fillestar	Plani rishikuar Qershor 2022	Realizmi 2022	Realizmi 2022 (%)
II Shpenzime (A)+(B)						
Shp. Operative (A)	Paga	12,947	13,769	6,727	5,597	
	Sigurime	2,195	2,306	1,134	935	
	Shërbime	5,700	5,100	2,033	1,003	
	Transferta					
Total (A)		20,842	21,715	9,894	7,535	
Shpenzime kapitale (B)	Investime			261	261	
Total (B)						

Burimi: SHF

Në total për vitin 2021, ku sipas PBA 2021-2023, nga SHSSH dhe Bashkia Korçë janë kërkuar 20,842 mijë lekë, nga të cilat fillimisht janë alokuar 21,715 mijë lekë dhe sipas buxhetit të rishikuar 20,814 mijë lekë. Realizimi shpenzimeve nga institucioni rezulton në vlerën 7,535 mijë lekë, ose 76 %.

Zbatimi i buxhetit për shpenzimet

Rakordimi shpenzimeve me Degën e Thesarit është bërë mujor e progresiv për çdo muaj deri në dhjetor te vitit kalendarik. Një kopje e situacionit dërgohet çdo muaj në SHSSH. Regjistrimi shpenzimeve behet sipas Urdhër Pagesës dhe sipas rendit kronologjik.

Për vitet 2019, 2020 dhe 2021, bazuar në situacionet e shpenzimeve sipas artikujve buxhetore llogaria 600, llogaria 601 dhe llogaria 602, paraqitet:

Situacionet e shpenzimeve sipas artikujve buxhetore (ne mijë lekë)

Artikulli	Emërtimi	2020		2021		6/2022	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
600	Shpenzime paga	12,010	11,924	12,026	11,549	6,727	5,597

601	Kont. për sig. shoq dhe shend	2,167	1,991	2,368	1,928	1,134	935
602	Shpenzime operative	4,516	4,460	5,213	4,793	2,033	1,003
602	Materiale zyre	500	492	800	777		
60201	Kancelari. printim	60	60	50	48		
60202	Materiale pastrimi dezinfektim	440	432	750	729		
6021	Materiale shërbim social	3,066	3,023	31,830	2,786	1,397	435
602101	Veshje uniform						
602102	Medikamente	60	60	60	60	48	43
602104	Ushqime	2,756	2,756	3,000	2,666	1299	370
602109	Te tjera	250	207	123	60	50	22
6022	Shërbime nga të tretë	910	910	1,087	1,087	636	568
602201	Energji	639	639	781	781	510	448
602202	Ujë	218	218	231	231	108	102
602203	Telefon. internet	26	26	26	26	14	14
602204	Poste	7	7	7	7	4	4
602207	Shërbim ruajtjes së sigurisë						
602099	Të tjera	20	20	42	42		
6023	Shpenzime transporti						
602301	Karburant. vaj						
602	Pjesë këmbimi						
602302	Siguracion. taksa						
6024	Udhëtim i brendshëm	25	24	115	115		
6029	Te tjera operative	15	11	28	28		
602903	Shpenzime gjyqësore						
602908	Tatime taksa						
606	Transferta për buxhetet familjare						
	Totali shpenzimeve	18,693	18,375	19,606	18,270	9,894	7,535
	Realizimi (Fakt/Plan)		98.3		93.18		76.15
231	Blerje pajisje	511	0	621	240	261	0
602	shpenzime						

Burimi: SHF, situacioni për realizim shpenzimesh

Shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore shoqërohen me dokument justifikues si listë pagesa e firmosur nga NZ, nga NA dhe firmosur dhe vulosur nga punonjësi Degës së Thesarit. Në strukturë shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore zënë **rreth 75% të shpenzimeve** korrente të vitit buxhetor.

Shpenzimet operative shoqërohen me dokument justifikues si urdhër-shpenzimi, fature blerje, flete hyrje ne magazine, urdhër prokurimi, kontrate furnizimi, proces verbal, etj. Në strukturë shpenzimet operative zënë 25 % të shpenzimeve korrente te vitit buxhetor.

-Shpenzime për materiale zyre zënë rreth **13.7%** të shpenzimeve operative, justifikohen me urdhër shpenzim, faturën e shitësit, flete hyrje në magazinë, etj.

-Shpenzime për materiale dhe shërbime sociale zënë rreth **62.8 %** të shpenzimeve operative, dhe këtu përfshihen shpenzimet për furnizim me ushqim, veshje uniforme, ilaçe për fëmijët, etj.,

mbështet në dokumentacion vërtetues si: kontrata e shpallur fituese me OK, fature tatimore shitje, flete hyrje në magazine, etj.

-Shpenzime nga të tretët zënë rreth **21.6%** të shpenzimeve korrente. Shpenzimet përfshijnë pagesa për energji elektrike, ujë, telefon, internet, shërbim i ruajtjes së sigurisë, etj. Shpenzimet bazohen në urdhër shpenzim, faturë shitje, urdhër prokurimi, kontrate shërbimi, etj.

-Shpenzimet e transportit përbëjnë **0%** të shpenzimeve operative. Ato paraqesin shpenzime për blerje karburanti për ngrohje me kalidajë dhe për automjetin e institucionit. Dokument vërtetues urdhër prokurimi, fatura e shitjes, flete hyrje në magazinë, etj.

-Shpenzime për udhëtim përbëjnë **1.5%** të shpenzimeve korrente të vitit 2020-2021, dhe më pas ka rënie të këtij shpenzimi. Ai paraqet shpenzimeve për udhëtime brenda vendit, jashtë qendrës së punës, për dërgimin e fëmijëve në festa dhe në funksione të tjera, mbështetur në dokumente vërtetues autorizim nga NA, Urdhër Shërbimi për punonjës të udhëtues.

-Të tjera shpenzime operative, janë për shpenzime pagesë fëmijëve dhe dezifektive, argëtime.

Nga auditimi konstatohet se, për të tre vitet objekt auditimi, mungojnë raportet e monitorimit 4-8-12 mujore të buxhetit të SHFSH, të cilat dërgohen në Shërbimin Social Shtetëror. Monitorimet dhe raportimet për ekzekutimin e buxhetit konsistojnë në rakordimet mujore dhe vjetore me degën e thesarit, si dhe në raportimet që Sektori i Administratës (Financa) bën për raportin vjetor të SHFSH, mbi Performancën e buxhetit të njësisë shpenzuese, duke mos lidhur realizimin e objektivave dhe produkteve me fondet përkatëse të planifikuara për arritjen e tyre. Mungesa e raporteve të monitorimit 4-8-12 mujore, si dhe relacioneve shpjeguese cenonë monitorimin e performancës financiare të objektivave të politikës së programit të synuara dhe produkteve të parashikuara në buxhetin vjetor, si dhe mungesën e marrjeve të masave korrigjuese që duhet të ndërmerren për përmirësimin e situatës, veprime në kundërshtim me pikën 42 kapitulli III të 41.2 kapitulli III, të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore” publik”, i ndryshuar.

ç) Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave dytësore

Burim i të ardhurave të tjera për Shtëpinë e Foshnjës Korçë, janë të ardhura nga donatorë të ndryshëm dhe tarifat e përcaktuara për birësimet.

Gjatë periudhës 2020-2021-Qershor 2022, pranë Shtëpisë e Foshnjës “Lulet e Vogla Korçë”, janë derdhur të ardhura nga donatorë dhe arkëtuar tarifa për birësimet.

Para periudhës objekt auditimi janë arkëtuar të ardhura në shumën 261, 000 lekë, me destinacion “shtesë kati për godinën” e cila çëlet çdo vit nga Bashkia Korçë dhe nuk kryhet asnjë punim.

Gjatë vitit 2020, janë arkëtuar të ardhura në shumën 78, 000 lekë, gjatë vitit 2021 është arkëtuar 1 tarifë birësimi në shumën 51,000 lekë, nga të cilat Shtëpia e Foshnjës përfiton 30% të shumës dhe 70% kalojnë për llogari të Bashkisë Korçë. Gjatë vitit 2022, nuk ka pasur donacione në vlerë ose të ardhura nga tarifat e birësimit.

Vitet	Të ardhurat
2020	78, 000 lekë
2021	51,000 lekë
2022	-

Përdorimi i të ardhurave është kryer referuar VKM nr.432, datë 28.06.2006 “Për krijimin dhe përdorimin e të ardhurave dytësore që krijojnë institucionet buxhetore” sipas përqindjeve të përcaktuara.

Përsa më sipër ngarkohet me përgjegjësi z.R.M, me detyrë shef i sektorit të financës.

Titulli i Gjetjes:	Mangësitë e konstatuara në përgatitjen e PBA-ve
Situata:	Nga krahasimi kërkesës buxhetore PBA 2019-2021 dhe buxhetit të miratuar për SHSSH, rezulton se plani i rishikuar në total 18,693 mijë lekë ka pësuar pakësim të shpenzimeve në shumën 139 mijë kundrejt planit fillestar. Sipas zërave buxhetor shpenzimet për paga janë pakësuar në shumën 498 mijë lekë, për sigurime shoqërore janë pakësuar në shumën 57 mijë lekë dhe shpenzimet për shërbime janë shtuar në shumën 416 mijë lekë. Buxheti i rishikuar i vitit 2020 rezulton me difference ndaj kërkesës buxhetore të institucionit në total në shumën 2,022 mijë lekë, dhe sipas zërave shpenzimet për paga janë miratuar më pak në shumën 933 mijë lekë, shpenzimet për sigurime janë miratuar më shumë në shumën 5 mijë lekë, shpenzimeve operative janë pakësuar më shumë së kërkesa buxhetore në shumën 1,094 mijë lekë. Për SHSSH PBA 2019-2021 nuk janë kërkuar shpenzime kapitale për vitin 2020, sepse këto kërkesa duhet të bëhen në Bashkinë Korçë. SHSSH prej vitesh nuk ka pranuar kërkesa për investime pasi këto investime do të bëhen nga pushteti lokal. Bashkia Korçë, ka planifikuar një fond prej 250 mije lekë dhe çelur gjatë vitit edhe një fond prej 261 mijë lekë, për ndërtim objekti (shtesë kati). Blerja e kompjuterave është realizuar në vlerën 240 mijë lekë por fondet u trashëguan për vitin 2021 njësisë shpenzuese. Vlera e fondeve për ndërtim u trashëgua për vitin 2021. Nga krahasimi kërkesës buxhetore PBA 2021-2023 dhe buxhetit të miratuar, rezulton se buxheti i rishikuar në vitin 2021 në total 19,606 mijë krahasuar me planin fillestar ka pësuar pakësim shpenzimesh në shumën 580 mijë lekë. Zërat buxhetorë të vitit 2021, kanë pësuar ndryshim kundrejt buxhetit fillestar për paga më shumë në shumën 1,726 mijë lekë dhe shpenzime për sigurime në shumën 33 mijë lekë dhe shërbime për 1,113mijë lekë. Buxheti i miratuar i vitit 2021 rezulton me diferencë ndaj kërkesës buxhetore në total për më pak në shumën -7,531 mijë lekë, nga të cilat shpenzimet për paga janë miratuar më pak në shumën -5,924 mijë lekë, shpenzimet për sigurime më pak në shumën -630 mijë lekë dhe shpenzimeve shërbime më pak në shumën -977 mijë lekë. Përsa i përket shpenzimeve kapitale për SHSSH nuk janë kërkuarshpenzime kapitale për vitin 2021, sipas kërkesës së njësisë shpenzuese, Bashkia Korçë ka miratuar fondin e kërkuar për 120 mijë lekë për sistemin zjarrfikës i cili nuk është realizuar për situatën e krijuar pas procedurës të deinstitutionalizimit.
Kriteri:	Ligji nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; Ligji Nr. 9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Udhëzimi i MFE nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat Standarde të përgatitjes së Programeve Buxhetore Afatmesme”, kreu 7.
Ndikimi/Efekti:	Mos miratimi i fondeve për investime në qendrën rezidenciale për shtesën e katit dhe sistemin zjarrfikës çon në rrezikimin e jetës së fëmijëve në rastet e rënies së zjarrit, dhe mos përmirësimi në hapësirat

	e dhomave ndikon në uljen e cilësisë së kushteve të jetesës për fëmijët rezident.
Shkaku:	Mos miratimi fondeve për investime në PBA i shumës së fondeve për investime të klasifikuara në llogarinë 231, pa vlerësuar shkallën e domosdoshmërisë së tyre.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandim:	Shtëpia e Foshnjes “Lulet e jetës”, në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror dhe Bashkinë Korçë, përpara miratimit të VKM-së për çeljen e fondeve buxhetore, të vlerësojnë rëndësinë dhe prioritetin e kërkesës për zërin “Investime” në llogarinë 231, në funksion të shëndetit, sigurisë dhe mirëqenies së fëmijëve rezident në institucion.

Titulli i Gjetjes:	Mungesa e raporteve të monitorimit 4-8-12 mujore
Situata:	Nga auditimi konstatohet se NA dhe NZ, për të tre vitet objekt auditimi, mungojnë raportet e monitorimit 4-8-12 mujore të buxhetit të SHF, të cilat dërgohen në Shërbimin Social Shtetëror. Mungesa e raporteve të monitorimit 4-8-12 mujore, si dhe relacioneve shpjeguese çënojnë monitorimin e performancës financiare të objektivave të politikës së programit të synuara dhe produkteve të parashikuara në buxhetin vjetor, si edhe mungesën e marrjes së masave korrigjuese për përmirësimin e situatës, veprime në kundërshtim me pikën 42 kapitulli III të 41.2 kapitulli III, të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore”.
Kriteri:	Ligji nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Ligji Nr. 9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 65, si dhe Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore”.
Ndikimi/Efekti:	Si rezultat i mungesës së raporteve të monitorimit të buxhetit: -Nuk bëhet e mundur ndjekja e arritjes së qëllimit dhe objektivave të synuar, për shkak të mos krahasimit të treguesve të planifikuar të performancës me treguesit faktik; - Nuk bëhet i mundur evidentimi nëse realizimi i produkteve është në përputhje me planin, në mënyrë që të kryhen propozime/rekomandime për ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese nëpërmjet alokimit të burimeve; - Nuk kryhet analiza krahasimore e realizimit të fondeve me periudhat e mëparshme; -Nuk sigurohet informacion për përmirësimin e procesit të planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit.
Shkaku:	Mungesë veprimesh nga strukturat përgjegjëse.
Rëndësia:	E mesme

Rekomandim:	Shtëpia e Foshnjes “Lulet e Vogla”, për shpenzimet e saj, të marrë masa, që të hartojë raportet e monitorimit 4, 8, 12 mujore, ku të relatohet në lidhje me realizimin e treguesve në raport me parashikimin. Në raportet 8 -mujore të paraqesë informacion shtesë për parashikimin e realizimeve të pritshme deri në fund të vitit, për të evidentuar nëse ky parashikim është më i lartë ose më i ulët se plani fillestar i parashikuar, me qëllim menaxhimin sa më efektiv të fondeve buxhetore, si dhe ndërmarrjen në kohë të veprimeve korrigjuese duke ndryshuar alokimin e burimeve dhe vlerësimin e prioriteteve duke evidentuar impaktin e mundshëm në performancën e objektivave të lidhura me to.
--------------------	--

2. Mbi administrimin e pronës shtetërore.

a) Inventarizimi dhe regjistrimi i pronës shtetërore.

-Regjistrimi i pronës shtetërore, procedurat për kalimin në pronësi dhe pasqyrimin në ASHK i pronësisë mbi truallin dhe objektin.

Shtëpia e foshnjes “Lulet e vogla” e ushtron veprimtarinë e saj në objektin e ndodhur në Korçë, me të dhëna si më poshtë:

-“**truall dhe ndërtesë**”, me nr. pasurie 3/62, ZK 8562, vol. 32, faqe 97, me sipërfaqe totale truall 600 m² dhe sipërfaqe ndërtese 190 m², në pronësi të Bashkisë Korçë.

Pasuria sipërcituar është pajisur me akte kadastrale, përkatësisht certifikatë për vërtetim pronësie me nr. 235390, lëshuar më datë 25.05.2010, sipas kërkesës së paraqitur me nr. 44263, datë 11.07.2006.

Për regjistrimin e pasurisë sipërcituar në favor të Bashkisë Korçë ka shërbyer vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 336, datë 31.05.2006 “Për transferimin në pronësi të disa Bashkive të pronave të cilat janë në përgjegjësi administrimi të drejtorisë së përgjithshme të shërbimit social shtetëror dhe për disa ndryshime në vendimin nr. 60, datë 1.2.2006 të Këshillit të Ministrave për miratimin e listës së inventarit të pronave shtetërore të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi drejtorisë së përgjithshme të shërbimit social shtetëror” (VKM 336/2006), e cila ndër të tjera ka vendosur transferimin në pronësi të bashkisë Korçë, objektin me nr. rendor 31, në formularin e inventarizimit të quajtur “Shtëpia e foshnjes 0-3 vjec”. Funkcioni për të cilin do të përdoret prona është vendosur “Qendër rezidenciale shërbimesh për foshnjat 0-3 vjec”.

Gjithashtu, referuar pikës 3, të VKM 336/2006 është vendosur që institucioni i shtëpisë së foshnjes, shërbimet shoqërore që ofrohen në to, të transferohen së bashku me ndërtesën, fondet, pajisjet, inventarin dhe personelin. Edhe pse bashkisë Korçë i është transferuar e drejta e pronësisë së truallit dhe ndërtesës me anë të VKM 336/2006, nga ana e saj nuk është marrë asnjë masë për përgatitjen dhe azhurnimin e formularit të inventarit të pronës (truall dhe ndërtesë) në kundërshtim me pikën 21, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, i cili parashikon se: “Që nga çasti i marrjes së listës përfundimtare të pronës që do të transferohet, çdo njësi e qeverisjes vendore është përgjegjëse për; a) mbajtjen e listës së inventarizimit të këtyre pronave; b) azhurnimin në vazhdimësi të listës së inventarit pas regjistrimit, sa herë që merren prona të reja, jepen ose shiten ose shfaqen interesa të palëve të treta, siç është dhënia me qira apo hipotekimi.” Formulari i vetëm për inventarizimin e pronës (truall dhe ndërtesë) është përgatitur në vitin 2006 me qëllim transferimin e pronës në pronësi të bashkisë Korçë në zbatim të VKM 336/2006 me përmbajtjen si më poshtë:

I. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHITËTËRORE

Institucioni i pushtetit qendror: Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror						Identifikoi: Ing. Bujar Bundo (Specialist investimesh) Supervizoi: Edmond Kuhi (Shef Shërbimesh) Aprovoi: Natasha Hodaj (Drejtor i Përgjithshëm)				
Bashkia Korçë										
Fusha e përdorimit të pronës: shërbime sociale										
Nr. rendor	Zona kadastr. & indeksi i hartës	Nr. i pasurisë	Lloji i pronës	Emri i pronës adresë	Sip. totale e pronës (m ²)	Nga sip. Totale: Sa e ndërtesës (m ²)	Funksioni për të cilin përdoret pronë	Institucioni/enti me përgjegjësi administrative	Institucioni/enti përdorues, statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
30			Truall Ndërtues	Godina e Qendrës së Zhvillimit Korçë	1560	410	Qendër shërbimesh për PAK	MPCSh Dr. Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror	Drejtoria e Qendrës së Zhvillimit	Ndërtues 2- katëshe
31			Truall Ndërtim	Godina e shtëpisë së foshnjës 0-3 vjeç Korçë	600	190	Qendër rezidenciale shërbimesh për foshnjat 0-3 vjeç	MPCSh Dr. Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror	Drejtoria e shtëpisë së foshnjës	Ndërtues 2- katëshe

U konstatua se godina ku ushtron veprimtarinë shtëpia e foshnjës “Lulet e vogla” është një ndërtim mbi 50 vjeçar. Bashkia Korçë (drejtoria e përgjithshme e pronës publike), në cilësinë e pronarit të pronës dhe shtëpia e foshnjës “Lulet e vogla”, në cilësinë e njësisë së varësisë që e përdor pronën, nuk rezultojnë të kenë ndërmarrë asnjë procedurë për kryerjen e auditimit teknik të godinës, me qëllim vlerësimin e gjendjes teknike dhe kapacitetin e tij mbajtës, në kundërshtim me nenin 4/1, ligji nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, ku cilësohet se “*Të gjitha objektet, të cilat kanë mbi 50 vjet që janë ndërtuar, i nënshtrohen procesit të auditimit teknik.*”

U vlerësua e nevojshme të kërkohej nga Bashkia Korçë dhe Shtëpia e Foshnjës “Lulet e vogla”, nëse ka pasur interesim nga subjekte private mbi zhvillimin e kësaj prone ose kërkesa për krijimin e çdo lloj marrëdhënie tjetër juridike civile me objekt pronën ku ushtron aktivitet shtëpia e foshnjës “Lulet e vogla”. Bazuar në përgjigjen e drejtoreshës së shtëpisë së foshnjës “Lulet e vogla” dhe drejtorit të drejtorisë së përgjithshme të pronës publike, nuk rezultoi që për këtë pasuri të ketë kërkesë nga subjekte private për zhvillim apo krijim të ndonjë marrëdhënie tjetër juridike civile.

I. Investimet për mirëmbajtjen e truallit dhe objektit.

Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, synon përkujdesjen dhe ndihmën për jetimët, detyrim ky që i buron nga neni 59, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Si rrjedhojë, një ndër funksionet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale është edhe ndërtimi dhe administrimi i qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale vendore, parashikuar në nenin 24 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar. Gjithashtu, neni 46, i ligjit nr. 126/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në republikën e Shqipërisë”, parashikon se njësia e qeverisjes vendore planifikon, ndërton, administron dhe mirëmban rregullisht shërbimet e kujdesit shoqëror, të ofruara brenda territorit të saj nëpërmjet buxhetit të njësisë së qeverisjes vendore.

Objekti ku ushtron aktivitet shtëpia e foshnjës “Lulet e vogla”, përkatësisht e llojit “truall dhe ndërtesë”, me nr. pasurie 3/62, ZK 8562, vol. 32, faqe 97, me sipërfaqe totale truall 600 m² dhe sipërfaqe ndërtese 190 m², 2 kate, aktualisht në pronësi të bashkisë Korçë, rezultoi i pasqyruar në pasqyrat financiare të shtëpisë së foshnjës “Lulet e vogla” dhe për vitin ushtrimor 2021 është reflektuar me vlerë 13,060,356 lekë.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 659, datë 17.10.2005 “Për standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për fëmijët në institucionet rezidenciale”, ndër të tjera ka parashikuar standardet dhe treguesit e cilësisë që duhet të plotësoj një institucion rezidencial për fëmijët. Më poshtë gjenden në formë tabelare standardet e kërkuara, treguesit e cilësisë dhe vlerësimi nga ana jonë mbi realizimin e tyre në ambientin e shtëpisë së foshnjës “Lulet e vogla”:

STANDARDI	TREGUES CILËSIE	REALIZUAR	KOMENTE
Shtëpia siguron mjedis fizik të përshtatshëm, mikëpritës, të një stili i shtëpiak dhe të një cilësie të mire për fëmijët, stafin, prindërit apo personat e tjerë të interesuar, në përputhje me qëllimin dhe funksionin e saj. Shtëpia mbahet në rregull.	Shtëpia zbkurohet dhe mobilohet për të krijuar një mjedis të këndshëm shtëpiak të përshtatshëm për numrin, gjininë dhe moshën e fëmijëve që strehohen atje.	Po	
	Shtëpia ku jetojnë fëmijët është një vend i sigurtë.	Po	
	Nuk ka më tepër se 6 fëmijë në dhomën e gjumit. Në dhoma fëmijët kanë një shtrat dhe pajisje shtrati të përshtatshme, vend për të ndenjur (për tu ulur), perde, apo mbulesa të tjera dritaresh, ndriçim të mjaftueshëm për të lexuar, tapet dhe mbulesa të tjera të përshtatshme dyshemeje si edhe ngrohje. Fëmijët kanë, dollapë për vendosjen e rrobave, që mund të mbyllet apo ndryshe vend të sigurtë të depozimit të gjërave të tyre personale.	Pjesërisht	Numri i shtretërve është më i madh se kriteri i përcaktuar. Kërkesat e tjera konsiderohen të plotësuar.
	Fëmijët janë të aftë dhe inkurajohen të personalizojnë dhomat e tyre të gjumit.	Po	
	Ekziston një dallim midis hapësirës private dhe të përgjithshme të banimit në shtëpinë në fjalë.	Po	
	Ka dhoma ku fëmijët mund të takohen privatisht me vizitoreë, si edhe hapësira për aktivitete private, për të luajtur, për të pushuar, të cilat nuk prekin aktivitetet e tjera të fëmijëve.	Po	

Në lidhje me numrin e fëmijëve në dhomën e gjumit, të cilët nuk mund të jenë më tepër se 6 fëmijë, duke ruajtur në këtë mënyrë raportin fëmijë-sipërfaqe në përputhje me hapësirën e Institucionit, rezulton se drejtoresha e shtëpisë së foshnjës “Lulet e vogla”, e ka përcjellë këtë problematikë pranë Bashkisë Korçë fillimisht me shkresën nr. 112 prot., datë 05.04.2017, duke kërkuar krijimin e mundësisë për ndërtimin e tri dhomave shtesë, me qëllim plotësimin e treguesit të cilësisë sipas standardit të miratuar. Në bazë të informacionit të përcjellë nga drejtoresha e Institucionit, në vijim të kësaj shkrese ka pasur komunikime vetëm verbale me përfaqësues të Bashkisë Korçë me qëllim planifikimin e investimit, por në kushtet e procesit të deinstitutionalizimit, u vendos mos të vijohej, duke qenë se edhe numri i fëmijëve në shtëpi ka qenë në rënie të vazhdueshme. Konstatohet se ambienti i plotëson të gjitha kushtet e kërkuara për të ofruar siguri tek rezidentët. Sistemi elektrik dhe hidraulik konstatohet se është funksional dhe i rregullt. Sistemi ngrohës është i përbërë nga sistemi i kaldajës dhe i kondicionimit, të dy këto sisteme janë në gjendje të rregullt dhe pune. Gjithashtu, konstatohet prezenca e shkallëve të emergjencës dhe fikëseve të zjarrit, me qëllim parandalimin e çdo situatë të papritur që mund të ndodhi në shtëpi. Rifiniturat e jashtme të objektit konsiderohen në gjendje të rregullt, objekti është i pajisur me dyer dhe dritare, të cilat janë

në kushte të rregullta dhe funksionale. Rrethimi i ndërtesës konsiderohet i rregullt dhe ofron siguri për rezidentët. Ambienti i jashtëm është i gjelbëruar dhe i pajisur me lodra për fëmijët. Referuar informacionit të përcjellë nga drejtoresha e Institucionit, duke qenë se objekti i plotëson të gjitha kriteret sipas standardeve të kërkuara, përgjatë periudhës së auditimit 01.01.2020 - 30.06.2022, rezulton se në Shtëpinë e Foshnjës “Lulet e vogla” nuk janë konsideruar të nevojshme të kryhen investime për mirëmbajtjen e truallit dhe objektit.

Më poshtë gjenden disa foto ilustruese të një pjese të ambientit:

Dhomë gjumi



Dhomë gjumi



Ambient kuzhine



Ambient kuzhine



Ambienti hyrës në godinë



Ambienti ku priten vizitorët



Ambienti jashtë



Në vlerësimin e audituesve, objekti ku ushtron veprimtarinë shtëpia e foshnjës “Lulet e vogla” nuk shfaq problematika në kapacitetin e saj mbajtës apo në gjendjen teknike, si dhe gjithashtu plotëson të gjitha kriteret arkitektonike dhe funksionale për të shërbyer si një institucion rezidencial për fëmijët, i cili referuar mobilimit dhe mirëmbajtjes krijon një ambient të këndshëm shtëpiak. Përsa i përket pozicionit të objektit pranë zonave të banuara, si edhe pranë Spitalit të Qytetit, hapësirës dhe cilësimeve të tjera të ngjashme konstatohet se ato janë në përputhje të plotë me standardet e miratuara për këtë lloj shërbimi.

U kërkua informacion nëse gjatë periudhës së auditimit ka pasur ose jo kontrole nga institucionet kompetente lidhur me plotësimin e standardeve të kushteve fizike të ambientit të jashtëm dhe të brendshëm. Nga ana e drejtoreshës së shtëpisë së foshnjës “Lulet e vogla”, si dhe bazuar në dokumentacionin provues, konstatuam se ka pasur inspektime nga Shërbimi Social Shtetëror, përkatësisht me akt monitorimin nr. 890/1 prot., datë 10.05.2022, por objekt monitorimi nuk ka qenë plotësimi i kushteve dhe standardeve të ambientit.

Ndërkohë, nuk administrohen gjurmë dokumentacioni për periudhën objekt auditmit 2020-2022 që të ketë pasur inspektime nga Inspektoriati Shtetëror i Shëndetësisë, i cili referuar nenit 35, ligji 121/2016, e ka kompetencë kontrollin e zbatimit të kriterëve dhe të kushteve nga subjektet publike që ushtrojnë veprimtari të ofrimit të shërbimeve shoqërore.

Sa më sipër u arrit në konkluzionin se:

-Bashkia Korçë (drejtoria e përgjithshme e pronës publike) nuk ka marrë asnjë masë për përgatitjen dhe azhurnimin e formularit të inventarit të pronës (truall dhe ndërtesë) në kundërshtim me pikën 21, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar;

-Bashkia Korçë (drejtoria e përgjithshme e pronës publike) dhe Shtëpia e Fëmijës “Lulet e vogla”, nuk kanë ndërmarrë asnjë procedurë për kryerjen e auditimit teknik të godinës, me qëllim vlerësimin e gjendjes teknike dhe kapacitetin e tij mbajtës, në kundërshtim me nenin 4/1, ligji nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar;

-Për periudhën objekt auditimi 2020-2022 nuk rezulton të ketë pasur inspektime nga Inspektoriati Shtetëror i Shëndetësisë, i cili e ka detyrë funksionale kontrollin e zbatimit të kriterëve dhe të kushteve nga subjektet publike që ushtrojnë veprimtari të ofrimit të shërbimeve shoqërore.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi zj. Znj. A.D, me detyrë drejtor i drejtorisë së përgjithshme të pronës publike.

Titulli i Gjetjes:	Mungesë në përgatitjen dhe azhurnimin e formularit të inventarit të pronës
Situata:	Nga auditimi u konstatua se Bashkisë Korçë, i është transferuar e drejta e pronësisë së truallit dhe ndërtesës me nr. pasurie 3/62, ZK 8562, vol. 32, faqe 97, me sipërfaqe totale trualli 600 m ² dhe sipërfaqe ndërtese 190 m ² , me VKM 336/2006, me qëllim vijimin e përdorimit të saj për të ushtruar veprimtarinë institucioni i shtëpisë së foshnjës. Pasuria sipërcituar është pajisur me akte kadastrale, përkatësisht çertifikatë për vërtetim pronësie me nr. 235390, lëshuar më datë 25.05.2010. Edhe pse bashkisë Korçë i është transferuar e drejta e pronësisë, nuk rezulton të jetë marrë asnjë masë për përgatitjen dhe azhurnimin e formularit të inventarit të pronës (truall dhe ndërtesë).
Kriteri:	Pika 21, VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti:	Mungesa në përgatitje dhe azhurnim të formularëve të inventarit të pronës con në mosparaqitje të saktë të informacionit lidhur me pronën, të tillë si: madhësia, interesa të palëve të treta, ndryshime të tjera, etj.
Shkaku:	Mungesë veprimesh nga strukturat përgjegjëse.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandim:	Bashkia Korçë (drejtoria e përgjithshme e pronës publike) të marrë masat për përgatitjen e formularit të inventarit të pronës, si dhe azhurnimin e saj në vijim.

Titulli i Gjetjes:	Mungesë e kryerjes së aktekspertizës së thelluar të objektit
Situata:	Godina ku ushtron veprimtarinë shtëpia e foshnjes “Lulet e vogla” është një ndërtim mbi 50 vjeçar. Bashkia Korçë (drejtoria e përgjithshme e pronës publike), në cilësinë e pronarit të pronës dhe shtëpia e foshnjes “Lulet e vogla”, në cilësinë e njësisë së varësisë që e përdor pronën, nuk rezultojnë të kenë ndërmarrë asnjë procedurë për kryerjen e aktekspertizës së thelluar të godinës, me qëllim vlerësimin e gjendjes teknike dhe kapacitetin e tij mbajtës.
Kriteri:	Neni 4/1, ligji nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar.
Ndikimi/Efekti:	Mungesa e kryerjes së aktekspertizës së thelluar në objekt, mbart riskun e të mosshprehurit saktë dhe drejtë të gjendjes reale të objektit, duke rritur rrezikun e rezidentëve në rast të ndodhjes të ndonjë situatë të papritur/fatkeqësi natyrore.
Shkaku:	Mungesë veprimesh nga strukturat përgjegjëse.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandim:	Bashkia Korçë të marrë masat për kryerjen e aktekspertizës së thelluar, duke vlerësuar gjendjen teknike të objektit dhe kapacitetet e tij mbajtëse.

Titulli i Gjetjes:	Mungesë e kryerjes së inspektimeve nga Inspektoriati Shtetëror i Shëndetësisë
Situata:	U kërkuar informacion nëse gjatë periudhës së auditimit ka pasur ose jo kontrole nga institucionet kompetente lidhur me plotësimin e standardeve të kushteve fizike të ambientit të jashtëm dhe të brendshëm. Nga informacioni i përcjellë nga Institucioni, si dhe bazuar në dokumentacionin provues, konstatoam se ka pasur inspektime nga Shërbimi Social Shtetëror, përkatësisht me akt monitorimin nr. 890/1 prot., datë 10.05.2022, por objekt monitorimi nuk ka qenë plotësimi i kushteve dhe standardeve të ambientit. Ndërkohë, nuk administrohen gjurmë dokumentacioni për periudhën objekt auditimi 2020-2022 që të ketë pasur inspektime nga Inspektoriati Shtetëror i Shëndetësisë, i cili e ka detyrë funksionale kontrollin e zbatimit të kriterëve dhe të kushteve nga subjektet publike që ushtrojnë veprimtari të ofrimit të shërbimeve shoqërore.
Kriteri:	Neni 35, ligji 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.
Ndikimi/Efekti:	Mungesa e kryerjes së inspektimeve nga Inspektoriati Shtetëror i Shëndetësisë, lidhur me zbatimin e kriterëve dhe kushteve në ambientin ku ushtron veprimtarinë Shtëpia e Foshnjes “Lulet e Vogla”, mbart

	riskun e të mosshprehurit saktë dhe drejtë të plotësimit ose jo të kushteve dhe standardeve në ambient, duke ndikuar në cilësinë e shërbimit të ofruar tek rezidentët.
Shkak:	Mungesë veprimesh nga strukturat përgjegjëse.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandim:	Inspektoriati Shtetëror i Shëndetësisë të marrë masa për të parashikuar në planin vjetor, kryerjen e inspektimeve në ambientin ku ushtron veprimtarinë shtëpia e foshnjes “Lulet e Vogla”.

3. Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.

- a) Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet arkës dhe bankës në lekë dhe valutë.
b) Saktësia dhe rregullat e veprimeve të kryera në magazinë.

Në lidhje me veprimet e kryera nëpërmjet bankës, është verifikuar dokumentacioni si më poshtë:

-Ditarët e Bankës

-Urdhër shpenzimet

-Dokumentacioni justifikues bashkëlidhur urdhër shpenzimeve

Institucioni nuk kryen veprime nëpërmjet arkës.

Nga auditimi i dokumentacionit për regjistrimin e hyrjeve dhe daljeve të aktiveve në magazinë nuk rezultuan parregullsi. Procesi i hyrjeve të aktiveve në magazine është dokumentuar me fletëhyrjet përkatëse, të hartuara sipas gjendjes fizike të tyre.

Shpenzimet në total, Shpenzimet operative dhe Investimet e realizuara nga Shtëpia e Foshnjes “Lulet e Vogla” dhe ato të audituara për periudhën objekt auditimi janë si më poshtë:

000 lekë

Shpenzimet sipas viteve	Total	Shpenzimet e audituara
Shpenzime total për vitin 2020	18,374	17,455
602	4,460	4,237
231		
Shpenzime total për vitin 2021	18,510	17,584
602	4,793	4,553
231	240	228
Shpenzime total për vitin 2022	7,796	7,406
602	1,003	953
Total i shpenzimeve	44,680	42,445

Dokumentacioni financiar për periudhën 2020-2022, nuk është mbajtur dhe regjistruar në ditarët kontabël kronologjikisht sipas destinacionit, por veprimet ekonomike janë të regjistruara sipas natyrës së shpenzimeve dhe të ardhurave dhe janë nënshkruar në të gjithë ekstremitetet dhe shoqëruar me dokumentet justifikues sipas shpenzimeve të kryera si, urdhër prokurime, kontrata, proces verbale marrje në dorëzim, etj., referuar udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Megjithëse nga sektori i financës dokumentacioni është mbajtur referuar legjislacionit në fuqi, u konstatuan se mungonin procesverbalet e marrjes në dorëzim të mallrave/shërbimeve.

Titulli i Gjetjes:	Mungojnë procesverbalet e marrjes në dorëzim
Situata:	Nga auditimi ka rezultuar se bashkëlidhur dokumentacionit justifikues të urdhër shpenzimeve, mungonte procesverbali i marrjes në dorëzim të mallrave/shërbimeve të prokurara.
Kriteri:	Udhëzimi nr.30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në njësitë e sektorit publik”.
Ndikimi/Efekti:	Nuk dokumentohen detajet për verifikimin e mallrave të marra në dorëzim.
Shkaku:	Nuk është treguar kujdes për hartimin e procesverbaleve nga komisioni i marrjes në dorëzim.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandim:	Komisionet e ngritura për marrjen në dorëzim të mallrave për çdo rast, të hartojnë procesverbale në të cilat të detajohen të dhënat e verifikuara dhe të evidentohet nëse ka mospërputhje me faturën dhe përcaktimet e kontratës dhe më pas të dorëzohen në Sektorin e Financës për likuidimin e pagesave.

Pika 4: Auditimi i llogarive vjetore:

a) Auditimi i bilancit kontabël dhe plotësimi i pasqyrave financiare përkatëse.
b) Auditimi i përllogaritjes së të ardhurave dhe shpenzimeve.
c) Vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur saktë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse si dhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.
Auditimi në drejtim të mbajtjes së kontabilitetit dhe hartimit të bilanceve kontabël u përqendrua në vlerësimin e saktësisë dhe përputhshmërisë ligjore të veprimeve ekonomiko-financiare dhe dokumentimit të transaksioneve financiare të realizuara gjatë periudhës objekt auditimi, si dhe në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, është verifikuar dokumentacioni i mëposhtëm:

- Pasqyrat Financiare të vitit 2021
- Relacioni shpjegues i llogarive
- Llogaritë analitike
- Rakordimet me thesarin
- Ditarët e Bankës

Auditimi u krye në lidhje me dy drejtimet e mëposhtme: mbi afatin ligjor të përcaktuar për përgatitjen e pasqyrave financiare dhe në vlerësimin e rregullshmërisë dhe saktësisë së llogarive dhe të pozicioneve të bilancit për çdo vit, si dhe kryerjen dhe dokumentimin e veprimeve në ditarin e përgjithshëm (ku janë regjistruar dhe veprimet e bankës), konform udhëzimeve të Ministrisë së Financave.

Pasqyrat financiare dërguar për vitin 2021, me shkresën nr.69 datë 23.03.2022 në Degën e Thesarit, përmbajnë të 8 Formatet e pasqyrave financiare dhe statistikore të miratuara referuar aneksit 2, udhëzimi nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, dhe janë të firmosura nga punonjësi zbatues dhe autorizues.

Nga auditimi kanë rezultuar disa problematika në regjistrimet kontabël referuar Udhëzimit nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” të cilat janë trajtuar sa me poshtë vijon:

Në pasqyrat e pozicionit dhe performancës financiare të vitit 2021, regjistrimi i llogarive kontabël nuk është bërë referuar regjistrimeve në ditarët kontabël por veprimeve ekonomike të rakorduara me Degën e Thesarit. Kështu, regjistrimi i të ardhurave dhe shpenzimeve nga personi përgjegjës për financën, nuk bëhet sipas destinacionit por sipas natyrës.

Regjistrimet e llogarive kontabël në pasqyrën e pozicionit financiar të vitit 2021 kanë qenë:
-Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”:

Detyrimet e muajit dhjetor 2021 që përfshin furnitorët:

Nr	Furnitori	Vlera për tu likuiduar	Data e likuidimit
1	U.K. Korçë	17,724	27.01.2022
2	OSHE	86,519	26.01.2022
3	Albtelekom	2,200	26.01.2022
4	Posta sha	480	26.01.2022
		106,923	

Dhe kreditorë të mbartur:

Emri i furnitorit	Shuma e faturës
E.K	9,340
F.P	13,704
F.R	32,545
F.R	22,546
F.R	17,268
F.R	2,820
F.R	4,341
“B”shpk	31,932
OSSHE	4,357
Total	138,853

-Llogaria 520 “Disponibiliteti në thesar” është pasqyruar në vlerën 706,965 lekë, të cilat janë transferim fondesh të pa shpenzuara gjatë vitit 2021 dhe kanë kaluar si të ardhura për vitin 2022.

-Nga auditimi ka rezultuar regjistrim i gabuar i llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në llogarinë 4342 “Operacione me shtetit” në vlerën 138,853 lekë, ndërkohë që kjo vlerë nuk paraqitet në asnjë llogari në pasiv, pra nuk ka kundërparti të llogarisë në pasiv.

-Në pasqyrën e pozicionit financiar për vitin ushtrimor nuk është pasqyruar llogaria 12 “Rezultatit të mbartur” e cila nga pikëpamja kontabël, në fillim të çdo viti ushtrimor, mbartet si rezultat i vitit ushtrimor të kaluar. Konkretisht, bëhet veprimi kontabël:

Debitohet llogaria 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore”; dhe

Kreditohet llogaria 12 “Rezultati i mbartur”.

-Në pasqyrën e ndryshimeve të aktiveve neto/ fondeve neto, llogaria 101 “aktivet neto/fondet neto” nuk është ajo e vitit paraardhës, llogaria 105 “Nga grantet e brendshme kapitale” është pasqyruar në vlerën 0, si dhe nuk është pasqyruar fitimi i vitit ushtrimor. Fondet neto përfshijnë zëra si: teprica apo deficit i akumuluar, rezultatet e mbartura, rezultati i veprimtarisë ushtrimore, rezerva nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata, etj. Për rrjedhojë, mënyra e përllogaritjes së “Fondit të akumuluar” në pasqyrën e pozicionit financiar nuk është e qartë.

-Nga personi përgjegjës për hartimin e pasqyrave financiare nuk është hartuar regjistri i aktiveve siç parashikohet në Udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe nuk mbahen llogaritë analitike të Aktiveve Afatgjata dhe Afatshkurtra së bashku me llogaritjen e amortizimit të tyre për çdo vit ushtrimor.

Titulli i gjetjes:	Parregullsi të rezultuara nga auditimi i pasqyrave financiare
Situata:	-Në pasqyrat e pozicionit dhe e performancës financiare të vitit 2021, regjistrimi i llogarive kontabël nuk është bërë referuar regjistrimeve në ditarët kontabël por veprimeve ekonomike të rakorduara me Degën e

	Thesarit. Kështu, regjistrimi i të ardhurave dhe shpenzimeve nga personi përgjegjës për financën, nuk bëhet sipas destinacionit por sipas natyrës. -Nga auditimi ka rezultuar regjistrim i gabuar i llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në llogarinë 4342 “Operacione me shtetit” në vlerën 138,853 lekë, ndërkohë që kjo vlerë nuk paraqitet në asnjë llogari në pasiv, pra nuk ka kundërparti të llogarisë në pasiv. -Në pasqyrën e ndryshimeve të aktiveve neto/ fondeve neto, llogaria 101 “aktivet neto/fondet neto” nuk është ajo e vitit paraardhës, llogaria 105 “Nga grantet e brendshme kapitale” është pasqyruar në vlerën 0, si dhe nuk është pasqyruar fitimi i vitit ushtrimor. Fondet neto përfshijnë zëra si: teprica apo deficiti i akumuluar, rezultatet e mbartura, rezultati i veprimtarisë ushtrimore, rezerva nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata, etj. Për rrjedhojë, mënyra e përlllogaritjes së “Fondit të akumuluar” në pasqyrën e pozicionit financiar nuk është e qartë. -Në pasqyrën e pozicionit financiar për vitin ushtrimor nuk është pasqyruar llogaria 12 “Rezultatit të mbartur” e cila nga pikëpamja kontabël, në fillim të çdo viti ushtrimor, mbartet si rezultat i vitit ushtrimor të kaluar. -Nga personi përgjegjës për hartimin e pasqyrave financiare nuk është hartuar regjistri i aktiveve dhe nuk mbahen llogaritë analitike të Aktiveve Afatgjata dhe Afatshkurtra së bashku me llogaritjen e amortizimit të tyre për çdo vit ushtrimor.
Kriteri:	Udhëzimi nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”. Udhëzimi nr.30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në njësitë e sektorit publik”.
Ndikimi/Efekti:	Informacioni në pasqyrat financiare nuk është i plotë.
Shkaku:	Nuk janë bërë regjistrimet referuar parimeve të kontabilitetit.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandim:	-Përgjegjësi i Sektorit të Administratës, para pasqyrimin të të dhënave në pasqyrat financiare, të regjistrojë në ditarët kontabël të gjitha transaksionet financiare të ndodhura gjatë periudhës ushtrimore. -Përgjegjësi i Sektorit të Administratës, të hartojë regjistrin kontabël të aktiveve dhe të përfshijë si aktivet afatgjata ashtu edhe aktivet afatshkurtra materiale dhe monetare me gjithë të dhënat e nevojshme që parashikon Udhëzimi nr.30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Gjithashtu, të hartohen llogaritë analitike dhe të llogaritet amortizimi i aktiveve afatgjata dhe afatshkurta të pasqyruara në pasqyrat financiare. - Përgjegjësi i Sektorit të Administratës të bëjë sistemimin e llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, llogarisë 4342 “Operacione me shtetit”, llogarisë 101 “Fondit të akumuluar” dhe llogarisë 12 “Rezultatit të mbartur”.

Procesi i inventarizimit, Për kryerjen e inventarëvetitullari i institucionit me urdhrin nr. 32, datë 07.12.2021 me objekt “Për realizimin e procesit të inventarizimit për vitin 2021” ka ngritur

komisionin e inventarizimit i përbërë nga 5 punonjës. Gjendja e inventarit nga ky proces ka rezultuar si më poshtë:

Lekë

Llog.	Gjendje Inventari qarkullues	Viti 2021
Total		9,170,861
31	Materiale	3,343,036
32	Inventar i imët	5,827,825
218	Inventar Ekonomik	3,112,611

Për kryerjen e inventarëvetitullari i institucionit me nr.28, datë 25.11.2020 me objekt “Për realizimin e procesit të inventarizimit për vitin 2020” ka ngritur komisionin e inventarizimit i përbërë nga 5 punonjës. Gjendja e inventarit nga ky proces ka rezultuar si më poshtë:

Lekë

Llog.	Gjendje Inventari qarkullues	Viti 2020
Total		8,796,617
31	Materiale	2,944,782
32	Inventar i imët	5,851,835
218	Inventar Ekonomik	2,856,351

Procesi i inventarizimit të aktiveve për vitet 2020 - 2021 nuk është bërë duke krahasuar gjendjen kontabël me gjendjen fizike. Gjithashtu, në fund të procesverbaleve mungon vlera totale e aktiveve, në disa nga procesverbalet të dhënat janë plotësuar me laps si dhe nuk është bërë evidentimi në rast se nga krahasimi i gjendjes fizike me atë kontabël ka mungesa ose teprica. Në fund të procesit të inventarizimit nuk është hartuar raporti përmbledhës i cili i paraqitet titullarit të institucionit për pasqyrimin e gjendjes së inventarit.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi z. R.M, me detyrë Përgjegjësi i Sektorit të Administratës.

Titulli i gjetjes:	Parregullsi të rezultuara nga procesi i inventarizimit të aktiveve
Situata:	Procesi i inventarizimit të aktiveve për vitet 2020 - 2021 nuk është bërë duke krahasuar gjendjen kontabël me gjendjen fizike të aktiveve. Procesverbalet për kryerjen e inventarizimit të mbajtura nga komisioni si për inventarin e imët edhe për inventarin ekonomik janë mbajtur për çdo zyrë. Në fund të procesverbaleve mungon vlera totale e aktiveve, të dhënat janë plotësuar me laps si dhe nuk është specifikuar në rast se kanë rezultuar mungesa apo teprica nga ky proces. -Në fund të procesit të inventarizimit nuk është hartuar raporti përmbledhës për t’ia paraqitur titullarit gjendjen e inventarit dhe diferencat midis gjendjes kontabël dhe gjendjes fizike.
Kriteri:	Germa b, c, pika 85,Udhëzimi nr.30, datë 27.12.2021 “Menaxhimi i Aktiveve të NJSP”.
Ndikimi/Efekti:	Procedura e inventarizimit nuk është kryer referuar kërkesave ligjore.
Shkaku:	Nuk janë ndjekur të gjitha hapat e procesit referuar Udhëzimit të MFE.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandim:	Titullari i institucionit të marrë masa për kryerjen e inventarëve në fund të çdo viti ushtrimor, duke caktuar në përbërje të komisioneve të inventarizimit të aktiveve specialistë të fushës, me qëllim kryerjen e inventarizimit me cilësi, pasqyrim të drejtë të procesit të inventarizimit, vlerësimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimi të aktiveve.

5. Prokurimet e fondeve publike.

Auditimi mbi prokurimet e fondeve publike, u fokusua në drejtimit e mëposhtme:

-Zbatimi i legjislacionit për realizimin e procedurave në prokurimet e fondeve publike;
-Zbatimi i kontratave të mallrave, shërbimeve dhe punimeve civile deri në marrjen në dorëzim të tyre;

- **Për vitin 2020**, sipas regjistrimit të parashikimit të procedurave të prokurimit janë parashikuar 18 procedura por në regjistrin e realizimit janë zhvilluar 9 procedura prokurimi. Nga këto 8 procedura me blerje të vogla me vlerë të fondit limit 915,841 lekë pa tvsh dhe vlerë kontrate 801,840 lekë, dhe 1 me vlerën e fondit limit 2,447,825 lekë pa tvsh dhe vlerën e kontratës 2,296,490 lekë. Nga procedurat me blerje të vogla 5 janë nën 100,000 lekë, 3 prej këtyre procedurave janë mbi 100,000 - 800,000 lekë.

-Për vitin 2020 është ngritur komisioni për procedurat e prokurimeve me urdhër të titullarit të institucionit nr 42. prot dhe data 29.01.2020, i përbërë nga z. R.M, znj. A.M dhe znj D. N. P. Me urdhërin nr. 6, datë 07.01.2020 "Për krijimin e komisionit të marrjes në dorëzim të aktiveve të furnizuara" është ngritur komisioni i përbërë nga znj. D.L, kryetare, znj. M.B anëtare dhe znj. Xh.M anëtare.

-**Në tenderin e zhvilluar me objekt: "Blerje ushqime"**, me të dhëna:

Urdhër Prokurimi Nr 42. datë 29.01.2020	Hartuesit e Dokumenteve të tenderit Nr. 01 datë 29.01.2020 R.M- (Kryetar) A.M- (Anëtar) M.S- (Anëtare)	Komisioni Vlerësimit Ofertave Nr.24 datë 29.01.2020 D.L-(Kryetar) E.A-(Anëtare) D.P- ""
Lloji i Procedurës "Kërkesë/propozim"		
Fondi Limit (pa Tvsh) 2,447,825 - lekë pa tvsh	Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje ushqime" me ofertën fituese S.M.p.f. " me ofertë në vlerën 2,296,490lekë	Diferenca me fondin limit: 151,335 - lekë pa tvsh
Data e hapjes së tenderit 17.02.2020	Burimi Financimit: Buxheti i Shtetit	Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 4 OE b) Skualifikuar 2 OE c) Kualifikuar 2 OE
Ankimime AK, Nuk Ka	Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	Përgjigje Ankesës Nuk ka

Hartimi i fondit limit. Me shkresën nr.277 prot, datë 18.12.2019, Autoriteti Kontraktor ka hartuar fondin limit, llogaritja e kuotave ushqimore sipas moshës së fëmijëve e kryer sipas muajve të vitit, duke ju referuar udhëzimit nr.689, datë 02.10.2018 "Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në Institucionet Publike Rezidenciale dhe Komunitare të Përkujdesjes Shoqërore. Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 23, të ligjit nr. 121/2016, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar dhe në pikën 71, të kreut V, të vendimit nr. 518, datë 4.9.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit.

Sigurimi i ofertave është hartuar në datë lëshimi 27.02.2020.

Hartimi i kriterëve. Hartimi i kriterëve të veçanta të kualifikimit, është bërë me procesverbalin nr.1, datë 29.01.2020 nga NJHDT bashkë me argumentimin e kriterëve.

Në procesverbalin nr.2, të datës 05.02.2020 është bërë shtojcë në dokumentin e tenderit, në DST, shtojca 9, të specifikimet teknike hiqet shprehja "prodhim vendi" në të gjitha rastet kur është përdorur.

Në datë 27.02.2020 është hartuar raporti përmbledhës bashkë me formularin e njoftimit të fituesit, dokument ky me nr prot. 59, datë 27.02.2020.

Me nr prot. 62, datës 28.02.2020 është lidhur kontrata me subjektin fitues **S.M** me vlerë limit 2.296.490 lekë pa tvsh dhe 2.755.788 lekë me tvsh.

Me urdhër nr.24 prot, datë 29.01.2020, është ngritur KVO e cila përbëhet nga znj. D.L(kryetare), znj. E.A dhe znj. D.P(anëtare). Në këtë procedure tenderi kanë marrë pjesë 4 OE, janë kualifikuar 2 OE, dhe shpallur fitues 1 OE, shoqëria "**S.M p.f.**" me ofertë në vlerën 2,296,490lekë me diferencë nga fondi limit në vlerën 151,335lekë. Është ngritur komisioni me urdhërin nr. 6 datë 07.01.2020, për ndjekjen e zbatimit të kontratës së ushqimeve i cili ka hartuar dhe procesverbalet për marjen në dorëzim së bashku me fletë hyrjet në magazine.

Nga shqyrtimi i ofertës fituese, rezulton se OE nuk përmbush të gjitha kriteret e vendosura në DST dhe konkretisht kriterin e pikës 4 të DST e cila kërkon nga OE "*... të ketë minimumi një objekt të përshtatshëm për ushtrim aktiviteti sipas objektit të prokurimit për të cilin konkurron. Për këtë objekt duhet të paraqesë akt-miratim higjieno-sanitar, të lëshuar nga organet kompetente të Ministrisë së Shëndetësisë, në të cilën duhet të jetë shënuar adresa e objektit për të cilin është lëshuar akt-miratimi higjieno-sanitar...*"

Për të përmbushur këtë kriter, është paraqitur një vërtetim hipotekor objekti lëshuar në emër të F.M, bashkëlidhur me 2 Akte Miratimi Higjieno-Sanitar në emër të S.M dhe L.G. Nuk ka asnjë kontratë që ambienti në emër të shtetasit F.M, të jetë dhënë për ushtrim aktiviteti shtetases S.M, e cila ka paraqitur ofertë në këtë procedurë.

-Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të AK nuk ka ekspert të fushës, në kundërshtim me VKM, Nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 58.

-Lidhur me Njësinë e prokurimit, asnjëri nga anëtarët e saj nuk ishte specialist fushe për hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit dhe hartimin e specifikimeve teknike, në kundërshtim me pikën 4, të nenit 57 "Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit" të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

-**Blerjet me vlera të vogla**, nga 8 procedura të blerjeve të vogla janë bërë përzgjedhje vetëm 3 procedura të cilat e kanë fondin limit mbi 100,000 lekë pa tvsh.

Me urdhërin me nr 27, datë 23.11.2020, titullari i Institucionit znj. K.Gj, ka krijuar komisionin e prokurimit me vlerë të vogël si më poshtë.

- R.M Kryetar
- D.H Anëtare
- A.H Anëtare

-Me urdhrin e prokurimit me nr 11, datë 16.11.2020, për prokurimin me vlerë të vogël "Bebelina" me një sasi prej 7300 copësh, me fondin limit 12,000 lekë pa tvsh ku vlera me TVSH shkon 15,000 lekë.

Hartimi i përlllogaritjes së fondit limit me nr.168 datë 16.11.2020.Me shkresën me nr prot. 170 datë 16.11.2020, ftesë për ofertë, AK zhvillon procedurën "blerje të vogla" me objekt prokurimi "bebelina" te shtëpia e foshnjës "Lulet e vogla" Korcë, me fond të vënë në dispozicion nga Bashkia Korcë. Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 21 OE ku nga këta të kualifikuar janë 17 OE dhe të skualifikuar janë 4 OE.

OE fitues është "H/2012" i cili kishte paraqitur vlerën prej 94,900 lekë pa tvsh por me proceverbalin nr.1, datë 19.11.2020 e përpiluar nga AK sqarohet se OE, H/2012 nuk është paraqitur brenda afatit kohor të percaktuar në DST për lidhjen e kontratës dhe furnizimin me mall dhe në zbatim të ligjit nr. 9643, viti 2006, "Për prokurimin publik" AK bën rivlerësimin e kësaj procedure duke kaluar tek operatori i dytë fitues i renditur "Z" shpk me vlerën 108,000 lek pa tvsh. Me nr. 204, datë 09.12.2020, është përpiluar ftesë për ofertë ku data e zhvillimit të kryer është 11.12.2020. Marja në dorëzim e mallit të prokuruar kryer me fletë hyrjet me nr. 7 datë 01.02.2020 në magazinën e Institucionit.

-Në urdhrin e prokurimit nr.12, datë 16.11.2020, blerje të vogël "Kompjutera" sasia 4 copë me fondin limit 208.333 lekë pa tvsh.

Hartimi i përlllogaritjes së fondit limit me nr.206, datë 14.12.2020. Ftesa për ofertë bashkë me karakteristikat teknike dhe kriteret e përgjithshme të kualifikimit, me nr.173 prot e datës 16.11.2020, ku data e zhvillimit të procedurës së prokurimit do të jetë 18.11.2020.

Formulari i anulimit të njoftimit me nr. 235 prot, datë 14.12.2020, me arsyen se nuk është paraqitur asnjë ofertë brenda afateve kohore.

Urdhëri i prokurimit tjetër me nr.20 prot, datë 14.12.2020, me të njëjtin përshkrim si dhe shkresa për ofertë me nr.208 prot datë 14.12.2020 me të njëjtat të dhëna.

Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 17 OE dhe me procesverbalin e datës 28.12.2020 të hartuar nga komisioni i Prokurimit me kryetar z. R.M me anëtare A.Z dhe D.H kanë, shpallur fitues shoqërinë "E.I" e 7-ta, e renditur në listën fituese pasi 6 OE-të e tjera janë tërhequr duke ju referuar procesverbaleve të mëposhtme: Procesverbali për kalimin tek operatori i radhës i datës 17.12.2020, për tërheqjen e OE "J" Group, Procesverbali për kalimin tek operatori i radhës i datës 18.12.2020, për tërheqjen e OE "O.T" Procesverbali për kalimin tek operatori i radhës i datës 19.12.2020, për tërheqjen e OE "S.Rr" Procesverbali për kalimin tek operatori i radhës i datës 21.12.2020, për tërheqjen e OE "AKM.A.I.G". Procesverbali për kalimin tek operatori i radhës i datës 22.12.2020, për tërheqjen e OE "E.H" Procesverbali për kalimin tek operatori i radhës i datës 24.12.2020, për tërheqjen e OE "A". Marja në dorëzim e mallit të prokuruar kryer me fletë hyrjet me nr.22 datë 28.12.2020, në magazinën e Institucionit.

-Me shkresën nr.176 prot është nxjerrë urdhëri i prokurimit nr. 13, datë 23.11.2020, për prokurimin me vlerë të vogël "Naftë për ngrohje" sasia 2400 litra.

Me shkresën nr. 177 prot datë 23.11.2020, ftesë për ofertë e kryer nga shtëpia e foshnjës "Lulet e vogla" Korçë. Në procesverbalin e datës 23.11.2020, e kryer nga komisioni është hartuar përlllogaritja e fondit limit referuar vendimit nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 59 "Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës" prej 2400 litra naftë për ngrohje. Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë 7 OE.

Firma fituese "M.O" është shpallur fitues me ofertën më të ulët. Marrja në dorëzim të mallit të prokuruar kryer me fletë hyrjet me nr 12, datë 11.12.2020 në magazinën e Institucionit. Nga Autoriteti Kontraktues është shlyer fatura brenda afatit me nr. 359 e datës 11.12.2020.

- Për vitin 2021, sipas regjistrave të parashikimit janë parashikuar 11 procedura prokurimi dhe nga regjistri i realizimit të dërguar në APP, janë zhvilluar 9 procedura 8 prokurime me vlerë të vogël, me fond limit 881,666 lekë dhe vlera e kontratës 721,108 lekë. Nga këto dy procedura prokurimi janë mbi 100,000 - 800,000 lekë. 1 procedure me vlerën limit 3,044,643 lekë pa tvsh e ndarë në dy lote.

-Për vitin 2021 është ngritur komisioni për procedurat e prokurimeve me urdhër të titullarit të institucionit nr. 02 prot datë 05.01.2021, i përbërë nga. z.R.M znj. M.S, znj. A.M

-Me urdhërin nr.27 datë 09.03.2021 "Për krijimin e komisionit të marjes në dorëzim të aktiveve të furnizuara" është ngritur komisioni i përbërë nga znj. K.A kryetare dhe znj. M.B anëtare dhe znj. M.V, anëtare.

-Në tenderin e zhvilluar me objekt: "Blerje ushqime dhe fruta perime", me këto të dhëna:

Urdhër Prokurimi Nr. 2, datë 05.01.2021	Hartuesit e Dokumenteve të tenderit Nr.1, datë 05.01.2020 R.M- Kryetar M.S- Anëtare A.M - Anëtare	Komisioni Vlerësimit Ofertave Nr.2 datë 05.01.2021 D.L- Kryetar E.A- Anëtare D.P- Anëtare
Lloji i Procedurës së Prokurimit: "Kërkesë për propozim"		
Fondi Limit (pa Tvsh)	- Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me	Diferenca me fondin limit:

3,044,643 - lekë i ndare ne dy lote Loti i pare 1,746,958 lekë Loti i dyte 1,297.685 lekë	objekt: “Blerje ushqime dhe fruta perime” me oferten fituese 1,679,200 lekë pa tvsh kualifikuar shoqëria “N”.	Loti i pare: 67,758 leke pa TVSH
Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit 18.01.2021	Burimi Financimit: Buxheti i Shtetit	Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 5 OE b) Skualifikuar 2 OE c) Kualifikuar 3 OE
Ankimime AK,Nuk Ka	Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	Përgjigje Ankesës Nuk ka

Loti 1. Produkte me origjinë shtazore 1,746,958 lekë

Loti 2. Produkte ushqimore dhe fruta perime 1,297,685 lekë

Hartimi i fondit limit, Me shkresën nr.194, datë 03.12.2020, është hartuar kërkesa për tu njohur me çmimet e INSTAT-it, për artikujt ushqimore për vitin 2021 dhe me urdhrin nr. 31 datë 14.12.2020 është hartuar përllogaritja e fondit limit.

Është hartuar gjithashtu dhe llogaritja e kuotave ushqimore sipas moshës së fëmijëve e kryer sipas muajve të vitit, duke ju referuar udhëzimit nr.689, datë 02.10.2018 "Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në Institucionet Publike Rezidenciale dhe Komunitare të Përkujdesjes Shoqërore. Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 23, të ligjit nr. 121/2016, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar dhe në pikën 71, të kreut V, të vendimit nr. 518, datë 4.9.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit.

Në shkresën me nr. 281, prot, datë 14.12.2020, e dërguar nga zyra rajonale e statistikave Korçë, dërgohen cmimet e artikujve ushqimore të llogaritur nga zyra rajonale statistikës Korçë.

Hartimi i kriterëve, Hartimi i kriterëve të veçanta të kualifikimit, me procesverbalin nr.1, datë 05.01.2021 nga NJHDT bashkë me argumentimin e tyre.

-Në kontratën me nr. 61 prot e datës 09.02.2021, me kontraktuesin shoqëria "N shpk" për lotin e 1 blerje "ushqimesh produkte me origjinë shtazore".

Në kontratën me nr. 46 prot e datës 05.02.2021, me OE shoqërinë "G" shpk për lotin 2 blerje "ushqime “produkte ushqimore dhe fruta perime”.

Me nr. 46 prot datë 05.02.2021, është hartuar formulari i raportimit të zbatimit të kontratës.

-Është ngritur komisioni me urdhrin nr.27 datë 09.03.2021, për ndjekjen e zbatimit të kontratës së ushqimeve i cili ka hartuar dhe procesverbalet për marjen në dorëzim së bashku me fletë hyrjet në magazinë.

-Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të AK nuk ka ekspert të fushës, në kundërshtim me VKM, Nr. 914 datë 29.12.2014, i ndryshuar me VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 75, pika 1.

-Lidhur me Njësinë e Prokurimit, asnjë nga anëtarët e saj nuk ishte specialist fushe për hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit dhe specifikimeve teknike, në kundërshtim me pikën 4 të nenit 57 “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit” të VKM-së nr.914, datë 29.12.2014 i ndryshuar me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Loti i Dytë

Urdhër Prokurimi Nr.1 datë 05.01.2021	Hartuesit e Dokumenteve të tenderit Nr. 1 datë 05.01.2020 R.M-Kryetar M.S- Anëtare A.M -Anëtare	Komisioni VlerësimitOfertave Nr.2 datë 05.01.2021 D.L Kryetar E.A Anëtare D.PAnëtare
Lloji i Procedurës së Prokurimit “Kërkesë për propozim”		
Fondi Limit (pa Tvsh) 3,044,643 - lekë pa tvsh i ndare ne	Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje ushqime dhe fruta	Diferenca me fondin limit: Loti i dytë: 25,665 leke pa tvsh

dy lote Loti i pare 1,746,958 lekë Loti i dyte 1,297.685 lekë	perime” me ofertën fituese me vlerë 1,272,020 lekë pa tvsh kualifikuar shoqëria ”G”.	
Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 18.01.2021	Burimi Financimit: Buxheti i Shtetit	Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 5 OE b) Skualifikuar 2 OE c) Kualifikuar 3 OE
Ankimime AK, Nuk Ka	Përgjigje ankesës Nuk ka	Përgjigje Ankesës Nuk ka

Njësia e prokurimit, Me shkresën nr.194, datë 03.12.2020, është hartuar kërkesa për tu njohur me çmimet e INSTAT-it për artikujt ushqimorë për vitin 2021 dhe me urdhërin nr.31 datë 14.12.2020 është kryer përllogaritja e fondit limit.

-Është hartuar gjithashtu dhe llogaritja e kuotave ushqimorë sipas moshës së fëmijëve, kjo e kryer sipas muajve të vitit, referuar udhëzimit nr.689, datë 02.10.2018”Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në Institucionet Publike Rezidenciale dhe Komunitare të Përkujdesjes Shoqërore. Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 23, të ligjit nr. 121/2016, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar dhe në pikën 71, të kreut V, të vendimit nr. 518, datë 4.9.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit.

-Në shkresën me nr prot. 281 datë 14.12.2020, e dërguar nga zyra rajonale e statistikave Korçë dërgohen cmimet e artikujve ushqimorë të llogaritur nga zyra rajonale statistikës Korçë.

Hartimi i kriterëve, Hartimi i kriterëve të veçanta të kualifikimit, me procesverbalin nr.1, datë 05.01.2021 nga NJHDT bashkë me argumentimin e tyre.

Në kontratën me nr. 61 prot, e datës 09.02.2021, AK ka lidhur kontratën me kontraktuesin shoqëria "N shpk" për lotin e 1 blerje "ushqimesh produkte me origjinë shtazore".

Në kontratën me nr. 46 prot, e datës 05.02.2021, AK ka lidhur kontratën me OE shoqërinë "G" shpk për lotin 2 blerje "ushqime produkte ushqimorë dhe fruta perime".

Me nr. 46 prot, datë 05.02.2021, është hartuar formulari i raportimit të zbatimit të kontratës.

-Eshtë ngritur komisioni me urdhërin nr. 27 datë 09.03.2021, për ndjekjen e zbatimit të kontratës së ushqimeve i cili ka hartuar dhe procesverbalet për marjen në dorëzim së bashku me fletë hyrjet në magazine.

-Nga shqyrtimi i ofertës fituese, rezulton se OE nuk përmbush të gjitha kriteret e vendosura në DST dhe konkretisht kriterin e pikës 2. 6/ *Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Certifikatë të Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimorë ISO 22000:2018 ose ekuivalente me të, certifikatë kjo që nuk disponohet nga OE.*

-Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të AK nuk ka ekspert të fushës, në kundërshtim me VKM, Nr. 914 datë 29.12.2014, ndryshuar me VKM nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 75.

-Lidhur me Njësinë e Prokurimit, asnjëri nga anëtarët e saj nuk ishte specialist fushe për hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit dhe hartimin e specifikimeve teknike, në kundërshtim me pikën 4 të nenit 57 “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit” të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar me VKM nr.285, datë 19.05.2021, neni 74 pika 2 dhe 4 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

-Blerje me vlera të vogla, nga 8 procedura prokurimi të blerjeve të vogla, janë perzgjedhur vetëm 4 procedura blerje të vogla të cilat e kanë fondin limit mbi 100,000 lekë.

Me urdhrin me nr. 04 datë 05.01.2021, titullari i Institucionit ka krijuar komisionin e prokurimit për blerje me vlerë të vogël për vitin 2021 si më poshtë:

- R.M Kryetar
- D.M Anëtare
- E.A Anëtare

-Me urdhrin e prokurimit me nr.25, datë 20.12.2021 për prokurimin me vlerë të vogël "naftë për ngrohje" sasia, 1115 litra me fondin limit 170.000 lekë pa tvsh.

Me shkresën nr. 291 prot datë 20.12.2021 është hartuar ftesë për ofertë.

Nga ana e Autoritetit Kontraktor është hartuar fondi limit i kësaj procedure me nr. 286 datë 07.12.2021. Me procesverbalin e datës 23.12.2021 është hartuar nga komisioni i AK me kryetar z. R.M dhe anëtare znj D.H dhe znj. E.Ak u rezulton se në këtë procedurë kanë marrë pjesë 7 OE. Fituesi është shoqëria "R-ER" si oferta më e ulët me fondin limit 170.000 lekë pa tvsh dhe 204.000 lekë me tvsh.

Marja në dorëzim të mallit të prokuruar kryer vetëm fletë hyrje me nr. 31 datë 23.12.2022, në magazinën e institucionit. Pagesa e faturës është brenda afatit të percaktuar në urdhrin e shërbimit me nr.157 datë 29.12.2021.

- Me urdhrin e prokurimit me nr. 25 datë 20.12.2021 për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël për "Bebelina" në sasinë 7100 copë.

Nga ana e Autoritetit Kontraktor është hartuar fondi limit i kësaj procedure me nr. 289 datë 20.12.2021

Ftesa për ofertë është hartuar me shkresën nr. 292 prot e datës 21.12.2021.

Kanë marrë pjesë 6 OE dhe me procesverbalin e datës 24.12.2021 komisioni ka vendosur se ka fituar OE me ofertën më të ulët shoqëria "Z Shpk" me fondin limit 114,700 lekë pa tvsh. Urdhrin e prokurimit me nr. 31 datë 23.12.2021 për prokurim me vlerë të vogël për "Bebelina" në sasinë 490 copë. Ftesa për ofertë është hartuar me shkresën nr. 296 prot e datës 23.12.2021. Ka marrë pjesë vetëm 1 OE shoqëria "Z Shpk" me fondin limit 10.300 lekë pa tvsh. Urdhri i shpenzimit me nr.161 datë 29.12.2021 është shlyer brenda afatit kohor. Marja në dorëzim të mallit të prokuruar kryer vetëm fletë hyrje me nr.33 datë 24.12.2021 në magazinën e Institucionit.

- Me urdhrin e prokurimit me nr .18 datë 12.11.2021 për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël "Naftë për ngrohje" sasia 1630 litra me fondin limit 250,000 lekë pa tvsh.

Nga ana e Autoritetit Kontraktor është hartuar fondi limit i kësaj procedure me nr 249 datë 10.11.2021. Me shkresën nr. 253 prot datë 12.11.2021, është hartuar ftesë për ofertë.

Kanë marrë pjesë 6 OE dhe me procesverbalin e datës 17.11.2021 komisioni prokurimit i AK ka vendosur të jetë fitues shoqëria "R-ER" i cili ka dhënë ofertën më të lirë.

Urdhër shpenzimet për procedurën me nr. 145 dhe 146 prot, të datave 15.12.2021 janë shlyer brenda afatit. Marja në dorëzim të mallit të prokuruar kryer vetëm fletë hyrjet me nr 22 datë 17.11.2021 dhe fletë hyrja nr.27 datë 13.12.2021 në magazinën e Institucionit.

-Me urdhrin e prokurimit me nr 16 datë 27.10.2021 për prokurimin me vlerë të vogël "blerje detergjentë" me fondin limit 83,333 pa tvsh.

Nga ana e Autoritetit Kontraktor është hartuar fondi limit i kësaj procedure me nr. 229 datë 27.10.2021. Procesverbal i datës 25.11.2021 i mbajtur nga komisioni i prokurimit për blerjet e vogla i krijuar me urdhrë të brendshëm, nr.04 datë 05.01.2021 në zbatim të urdhrin të prokurimit me nr. 16 datë 27.10.2021 me objekt "Blerje detergjentë dhe materiale pastrimi". Procedura e prokurimit u bë në formë të drejtpërdrejtë duke u bazuar në pikën 2/a "Prokurimit me vlerë të vogël" konkursi i projektimit, të VKM nr 1 datë 10.01.2007, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar". Komisioni pasi testoi tregun kontrolloi dhe ofertat nga OE, I.P, A.S, I.T dhe M.H. Komisioni shpalli fitues OE M.H me ofertën më të ulët në vlerë 48,450 lekë me tvsh.

Urdhër shpenzimet për procedurën blerje të detergjentëve janë bërë me faturë tatimore shitje të datës 25.11.2021 pagesa "e-faturë" janë shlyer brenda afatit bashkëlidhur urdhëri i shërbimit me nr.144 datë 15.12.2021. Marja në dorëzim të mallit të prokuruar kryer vetëm fletë hyrjet me nr 24 datë 25.11.2021 në magazinën e institucionit.

- Për 6-mujorin I të vitit 2022, sipas regjistrimit të parashikimeve janë parashikuar 5 procedura

prokurimi dhe në regjistrin e realizimeve është zhvilluar 1 procedurë prokurimi "Blerje të vogla" me fond limit 1,000,000 lekë dhe vlerë kontrate 994,575 lekë dhe 1 procedure "blerje e vogël" medikamente me vlerë fondi limit 42,973 lekë pa tvsh.

-Për vitin 2022 është ngritur komisioni për procedurat e prokurimeve me urdhër të titullarit të institucionit nr. 26 prot datë 21.06.2022, i përbërë nga z. R.M, znj. A.T dhe znj. Xh.M.

Me urdhërin nr.7 datë 05.01.2022" Për krijimin e komisionit të marjes në dorëzim të aktiveve të furnizuara" është ngritur komisioni i përbërë nga znj. K.A kryetare dhe znj. M.B anëtare dhe znj. M.V, anëtare.

- **Blerje me vlera të vogla**, me urdhrin me nr. 03 datë 05.01.2022, titullari i Institucionit ka krijuar komisionin e prokurimit për blerje me vlerë të vogël për vitin 2022 si më poshtë:

- R.M Kryetar
- A.T Anëtare
- Xh.M Anëtare

- **Me shkresën me nr. 138 prot ka dalë urdhri i prokurimit nr. 6 datë 21.06.2022 për procedurën e prokurimit blerje të vogël "mallra ushqimore" me fondin limit 994,575 lekë pa tvsh.**

Me urdhrin nr.7 datë 05.01.2022 "Për krijimin e komisionit të marjes në dorëzim të aktiveve të furnizuara" me komisionin, kryetare K.A dhe anëtare M.B dhe M.V.

Me nr.137 prot, ka dalë urdhri me nr. 26 datë 21.06.2022, për krijimin e komisionit me vlerë të vogël, ku kryetar është z R.M, znj A.T dhe znj. Xh.M anëtare.

Me nr. 136 prot, ka dal urdhri me nr .25 datë 21.06.2022 është krijuar komisioni i vlerësimit të ofertave me kryetare znj. KA, dhe znj E.A e znj. D.P.

Nga ana e Autoritetit Kontraktor është hartuar fondi limit i kësaj procedure me nr 110.1 datë 23.05.2022.

-Është hartuar gjithashtu dhe llogaritja e kuotave ushqimore sipas muajve përkatës (janar-qershor), referuar moshës së fëmijëve sipas udhëzimit nr.689 datë 02.10.2018 "Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në Institucionet Publike Rezidenciale dhe Komunitare të Përkujdesjes Shoqërore. Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 23, të ligjit nr. 121/2016, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar dhe në pikën 71, të kreut V, të vendimit nr. 518, datë 4.9.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit.

Ftesa për ofertë me nr.139 prot, datë 21.06.2022, ka dalë nga titullari i Autoritetit Kontraktor.

Në datën 27.06.2022 në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë 4 OE, L.Xh, O.H, "A-A" dhe "G". Në datë 27.06.2022 është mbajtur një procesverbal nga komisioni ku sqaron se oferta më e ulët është OE me përfaqësues z. L.XH me vlerën 928.000 lekë pa tvsh i cili tërhiqet nga procedura.

Me procesverbalin e datës 28.06.2022 mbajtur procesverbal nga komisioni i cili i drejtohet operatorit të dytë në rradhë OE me përfaqësues z. O.H me vlerë të ofertuar 984.400 lekë pa tvsh i cili është tërhequr nga procedura. Me procesverbalin e datës 29.06.2022 mbajtur nga komisioni i cili i drejtohet OE së tretë shoqërisë "A-A "me vlerë të ofertuar 987.999 lekë pa tvsh, i cili më pas është tërhequr nga procedura. Formulari i ofertës fituese i datës 30.06.2022 i bërë nga shoqëria "G" shpk me vlerën e ofertës 994,575 lekë pa tvsh. Në datën 01.07.2022 me nr serial. 2173 është bërë formulari i sigurimit të kontratës nga shoqëria e sigurimeve "I" SHA. Procesverbali i komisionit me kryetare znj. K.A dhe anëtare znj. M.V e znj. M.V dhe znj. E.A, për marjet në dorëzim të aktiveve të furnizuara së bashku me fletë shoqërimin e furnizuesit dhe fletë hyrjet në magazinë. OE nuk përmbush kriterin e pikës 2,6 DST ku thuhet se Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Certifikatë të Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore ISO 22000:2018 ose ekuivalente me të, certifikatë kjo që nuk disponohet nga OE.

-**Urdhër prokurimi me nr.3 datë 20.04.2022 për procedurën e prokurimit me blerje të vogël "medikamente mjekësore" me fondin limit 42,973 lekë pa tvsh.**

Nga Autoriteti Kontraktor është hartuar fondi limit i kësaj procedure me nr. 89, datë 20.04.2022. Në procesverbalin e datës 11.05.2022, i mbajtur nga komisioni me kryetar z. R.M dhe anëtare znj. A.T dhe znj. Xh.M sqarohen se kanë testuar tregun dhe ofertuesi me i ulët ishte OE L.Q me ofertën 42,973 lekë pa tvsh. Në këtë procesverbal nuk janë pasqyruar ofertat e dhëna nga OE të tjerë. Medikamentet mjekësore kanë hyrë në magazinë me fletë hyrjen nr.5, datë 11.05.2022, por mungon procesverbali i marrjes në dorëzim të tyre.

Titulli i gjetjes:	Mangësi në procedurat prokurimit me objekt “Blerje ushqime”.
Situata:	- Në procedurën e prokurimit “Blerje ushqime” OE nuk përmbush kriterin e pikës 2.6 të DST-ve, ku citohet “Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Certifikatë të Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore ISO 22000:2018 ose ekuivalente me të” certifikatë kjo që nuk disponohet nga OE. -Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të AK nuk ka ekspert të fushës, në kundërshtim me VKM, Nr. 914 datë 29.12.2014, ndryshuar me VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 75. -Lidhur me NJP, asnjëri nga anëtarët e saj nuk ishte specialist fushe për hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit dhe hartimin e specifikimeve teknike, në kundërshtim me pikën 4 të nenit 57 “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit” të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar me VKM nr.285, datë 19.05.2021, neni 74 pika 2 dhe 4 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. - Në lidhje me kriteret e vendosura, u konstatuan edhe kriteret të cilat nuk i shërbejnë procedurës dhe mbartin risk për menyrën e formulimit si më poshtë: Kërkesa e pikës 4 në DST e cila kërkon nga OE të disponojnë në pronësi ose me qira një automjet për transportin e mallrave objekt prokurimi, është kërkuar të paraqesë si dokumentacion shoqërues, lejen e qarkullimit shoqëruar me akt miratimin higjeno-sanitar. Kjo kërkesë ka mangësi dhe është minimaliste pasi nuk janë kërkuar dokumente të rëndësishme të mjetit si polica e sigurimit, akti i kolaudit, certifikata e pronësisë së mjetit, dokumente këto të rëndësishme për mbarrëvajtjen e transportit të sigurtë të mallrave dhe ushqimeve, si dhe mbarrëvajtja e rregullt e procedurës deri në zbatim të saj. Kriteri i mësipërm nuk përmbush parashikimet e dispozitave ligjore të zbatueshme për prokurimin publik, referuar pikës 1 të nenit 46 të ligjit Nr. 9643 vitit 20.11.2006, “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pikës 3 të nenit 27 të VKM-së Nr.914 viti 2014, i ndryshuar me VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. -Për vitin 2020 AK nuk ka marrë parasysh faktin se mallrat objekt prokurimi nuk janë të njëjta dhe si e tillë kjo procedurë duhej të shpallej me lote, kjo për të krijuar mundësinë e OE-ve që të mund të paraqesin oferta vetëm për njërin nga mallrat ose grup mallrash objekt prokurimi, pasi forma

	e ndjekur nga AK është në kundërshtim me parimet dhe qëllimin e rregullave të prokurimit publik. Neni 29 “Kontrata për punë/mall/shërbim e ndarë në lote” e VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, përcakton se: "Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, AK duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit”.
Kriteri:	- Ligji nr. 9643 datë 20.11.2016 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ligji nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar; - VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar; - VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar; - Udhëzimi i Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 3, datë 08.01.2018 “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël”; - Udhëzimi i ndryshuar me nr. 85, datë 25.06.2021” Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike.
Shkaku:	Mungesë e stafit me specialistë të fushës.
Ndikimi/Efekti:	Mos dhënia e garancisë për mbarëvajtjen e rregullt të zbatimit të kontratës.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandim:	Titullari i AK, të marrë masa në vijimësi për ngritjen e komisioneve të zhvillimit të procedurave të prokurimit me specialistë të fushave të caktuara sipas objektit të prokurimit në përputhje me përcaktimet ligjore, me qëllim hartimin e kriterëve/specifikimeve teknike që mundësojnë përdorimin me efektivitet të fondeve publike.

Titulli i gjetjes:	Mangësi në procedurat blerjeve me vlera të vogla
Situata:	-Në 7 raste të audituara, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim të mallit, dhe në disa raste likuidimi i mallit është bërë pa i marrë ato në dorëzim. -Ne 3 raste të audituara likuidimi i faturave është tej afatit ligjor 30 ditor, veprim në kundërshtim me nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.06.2009 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" -Në procedurën me objekt “<i>Blerje karburanti</i>” e vitit 2020, mungon lidhja e kontratës ndërmjet AK dhe OE.
Kriteri:	- Ligji nr 9643 datë 20.11.2016” Për prokurimin publik” i ndryshuar, ligji nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar. - Ligji nr.9936, datë 26.06.2009 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Neni 52. - VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Neni 77; - VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar;

	- Udhëzimi i Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 3, datë 08.01.2018 “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël”; - Udhëzimin e ndryshuar me nr.85, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”; - Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 42, 43, 44,52, 53 dhe 54.
Shkaku:	Mos respektim i kërkesave ligjore për marrjen në dorëzim të mallit dhe likuidimin e faturave.
Ndikimi/Efekti:	Magazinimi i mallrave jashtë kushteve të përcaktuara dhe specifikimeve teknike duke ulur cilësinë.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandim:	Autoriteti Kontraktor të marrë masa që komisionet e blerjeve me vlera të vogla, të pasqyrojnë me procesverbal marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve, të ndjekë afatet për likuidimin e faturave brenda afateve ligjore, me qëllim prokurimin e tyre sipas kriterëve dhe cilësinë e kërkuar.

6. Probleme të ndryshme që mund të dalin gjatë Auditimit.

Plani Kombëtar i Deinstitutionalizimit 2020-2022 dhe impakti i tij në Shtëpia e Foshnjës “Lulet e Vogla”, Bashkia Korçë.

Shtëpia e Foshnjës “Lulet e Vogla” Korçë, është një Institucion i Shërbimit të Përkujdesjes Publike në varësi të dyfishtë të MSHMS-së dhe Bashkisë Korçë.

Shtëpia ka si qëllim mirërritjen, kujdesin shëndetësor dhe social për fëmijët, edukimin, arsimimin, trajtimin psiko-social të fëmijëve nga mosha 0-6 vjeç. Shtëpia e Foshnjës “Lulet e Vogla” ka për detyrë të krijojë për fëmijët kushtet dhe karakteristikat e një ambienti familjar, ti integrojë ata në ambientin jashtë institucionit dhe t’i vendosi në mjedis familjar, me përparësi atë të origjinës.

Ky institucion është në proces pilotimi deri në fund të vitit 2022, me qëllim transformimin e shërbimit për të ofruar shërbime alternative referuar VKM nr.706, datë 09.09.2020 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit 2020-2022, dhe të Planit të Veprimit për zbatimin e tij”.

Procesi i deinstitutionalizimit të sistemit të kujdesit për fëmijët, bazohet në ndryshimin e tipologjisë së ofrimit të shërbimeve, nga institucione rezidenciale në shërbime ditore, si dhe shërbime të tjera alternative, me bazë komunitare, duke u përqendruar në integrimin e fëmijëve në familje, qofshin ato biologjike apo kujdestare, në komunitete dhe shoqërinë e gjerë, duke respektuar interesin më të lartë të fëmijës.

Në zbatim të Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit, MSHMS ka miratuar projektin e propozuara nga Bashkia Korçë për ngritjen e shërbimeve mbështetëse për fëmijën dhe familjen dhe financimin e tyre nëpërmjet Fondit Social buxhetor. Ky projekt parashikon arritjen e 3 objektivave si vijon:

-Parandalimi i ndarjes së fëmijëve nga prindërit dhe deinstitutionalizimi nëpërmjet Ri-integritit me familjet biologjike ose kujdestare;

-Familjet dhe fëmijët përfitojnë shërbime të specializuara që adresojnë nevojat e shfaqura në aspektin e shëndetit fizik, mendor, si dhe rritja e kapaciteteve të familjeve dhe ofrimi i mundësive për tu rikuperuar gjatë fazave kur prindi nuk mund të ushtrojë përgjegjësitë e tij;

-Pilotimi i kujdesit alternativ profesional për fëmijët prindërit e të cilëve nuk mund të ushtrojnë kujdes prindëror për një kohë të caktuar.

Afati i zbatimit të Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit është drejt përfundimit, referuar VKM-s së mësipërme (fund viti 2022), por objektivat e përcaktuara nuk janë arritur ende nga procesi i pilotimit në Bashkinë Korçë.

Nga auditimi është konstatuar se struktura e ngritur nga Bashkia Korçë, “Për Shërbimin dhe Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Familjes”, është angazhuar vetëm në parandalimin e institucionalizimit të fëmijëve dhe jo në deinstitutionalizimin e tyre që aktualisht ndodhen në qendrën rezidenciale. Deri tani, nuk ka rezultuar me sukses procesi vlerësimit dhe rikthimit në familje të fëmijëve të institucionalizuar por është konstatuar se fëmijët e kësaj qendre rezidenciale janë larguar për arsye birësimi dhe për shkak të arritjes së moshës për transferimin në qendra rezidenciale të tjera për fëmijë të moshës nga 6-18 vjeç, ndërkohë që për periudhën 2020-2022 vetëm 3 fëmijë janë rikthyer në familjet biologjike.

Në Planin Kombëtar të Deinstitutionalizimit është evidentuar si problem numri shumë i vogël i familjeve kujdestare pa lidhje gjaku (më pak se 10 në të gjithë Shqipërinë). Në Bashkinë Korçë, edhe pse kanë kaluar dy vite nga procesi i pilotimit të këtij plani, mungon një listë e familjeve kujdestare pa lidhje gjaku. Ky fakt, bën të pamundur deinstitutionalizimin e fëmijëve të cilët nuk mund të kthehen në familjet biologjike apo në familje me lidhje gjaku.

Moratoriumi i vendosur për pilotimin e Planit të Deinstitutionalizimit në Bashkinë Korçë, ka sjellë si pasojë që rastet e reja të fëmijëve që kanë nevojë për institucionalizim në Shtëpinë e foshnjës “Lulet e Vogla” Korçë, të institucionalizohen në IPSH të tjera në Shqipëri. Si rezultat, për fëmijët dhe familjet krijohet problem në komunikim dhe në ndjekjen e kujdestarisë së prindërve për fëmijët (detyrimi për paraqitje dhe interesim i prindërve brenda 6 muajsh) si pasojë e vështirësive ekonomike që kanë këto familje për të udhëtuar drejt qendrave rezidenciale jashtë Bashkisë Korçë. Kështu, nga ky proces jo vetëm nuk është arritur deinstitutionalizimi i fëmijëve, por krijohet një problem i ri, i cili është trajtimi i rasteve të reja të fëmijëve të institucionalizuar larg familjeve biologjike duke u bërë pengesë për forcimin e marrëdhënies së fëmijës dhe familjes (një nga objektivat më të rëndësishme të Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit).

Plani i Deinstitutionalizimit 2020-2022, në zbatim të interesit më të lartë të fëmijës përfshin një hap shumë të rëndësishëm që është ai i vlerësimit të Institucioneve të Shërbimeve të Përkujdesjes publike (IPSH-ve) duke përfshirë hapat e mëposhtme:

- Vlerësimin e fëmijës rezident në institucion dhe familjes biologjike ose kujdestare,
- Vlerësimin e kapaciteteve të stafit të IPSH Korçë,
- Nevojat financiare dhe mbulimin e kostove për realizimin e transformimit të Institucionit,
- Vlerësimin e infrastrukturës dhe pajisjeve të Institucionit për transformimin e shërbimit,
- Përgatitjen e një programi konkret për transformimin e institucionit.

Ky proces i vlerësimit dhe transformimit të shërbimeve nuk është arritur për Shtëpinë e Foshnjës Korçë (përveç procesit të vlerësimit të fëmijës dhe familjes). Pushteti vendor dhe qendror nuk kanë hartuar ende plane për transformimin e Shtëpisë së Foshnjës Korçë si institucion dhe si shërbim. Si rezultat, edhe pse afati për pilotimin e procesit të deinstitutionalizimit të Shtëpisë së Foshnjës “Lulet e Vogla” Korçë është duke përfunduar në fund të vitit 2022, referuar Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit, aktualisht ky institucion i përbërë nga një personel prej 17 punonjësish do të vazhdojë të funksionojë në kushtet kur ka vetëm 6 fëmijë rezident, dhe nuk ka plan për fëmijët rezident dhe as për transformimin e institucionit.

Aktualisht lëvizjet e fëmijëve rezidentë në këtë institucion paraqiten si vijon:

Nr.	Emër Mbiemër	Vendlindja	Kthim ne familjen biologjike	mosha 3-6 vjeç	Largimet/ Transferimet
1	D.T	Tirane	Jo	7 vjeç	Larguar
2	A. S	Korçë	Jo	6 vjeç	Larguar

3	I. Sh	Korçë	Jo	6 vjeç	Larguar
4	E.Ç	Pogradec		2 vjeç	Birësuar
5	A.K	Korçë		6 vjeç	Birësuar
6	S. K	Korçë	Jo	5 vjeç e 11m	për tu larguar
7	A. T	Korçë	Jo	5 vjeç e 11m	për tu larguar
8	E. S	Korçë	Jo	5 vjeç e 11m	për tu larguar
9	S.D	Korçë	Jo	6 vjeç	Larguar
10	S. K	Korçë		5 vjeç	Birësuar
11	J.K	Korçë	Jo	3 vjeç	për 3 vjetL
12	M.Sh	Bilisht	Jo	5 vjeç	për 5 muaj L
13	K. Sh	Bilisht	Jo	4 vjeç	për 2 vjet L

Burimi: IPSH Korçë

Nga 13 fëmijë rezidentë në fillim të vitit 2022, 3 prej tyre janë birësuar, 4 fëmijë janë transferuar në IPSH të tjera për shkak të moshës dhe 3 fëmijë duhet të transferohen në një IPSH tjetër për shkak të mbushjes së moshës. Si rrjedhojë, në IPSH Korçë deri në fund të muajit dhjetor mbeten vetëm 3 fëmijë rezidentë të cilët janë ende larg mbushje së moshës për tu transferuar.

Si pasojë e situatës së krijuar sa trajtuar më sipër, Titullari i Institucionit të Shtëpisë së foshnjës “Lulet e Vogla” me shkresën nr.178 prot, datë 31.08.2022 drejtuar Bashkisë Korçë dhe Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka dërguar Informacion mbi ecurinë e procesit të Deinstitutionalizimit në Shtëpinë e Foshnjës “Lulet e Vogla” Korçë. Nëpërmjet kësaj shkrese është kërkuar informacion lidhur me ecurinë e mëtejshme të institucionit dhe se si do të vijojë puna kur numri i fëmijëve rezident është në rënie si efekt i moratoriumit të vendosur për pranime të reja. Nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me shkresën nr. 3480/1, datë 17.10.2022 është kthyer përgjigje se ky institucion do të transformohet në shërbime alternative të përkujdesit për fëmijët në nevojë, duke përfshirë shërbimet rezidenciale emergjente, ditore komunitare, si dhe tipologjitë e reja të kujdestarisë së përkohshme, bazuar në një plan pune me afate kohore të drejtuar nga Shërbimi Social Shtetëror. MSHMS shprehet se në bashkëpunim me Komitetin drejtues është në fazë konsultimi të planit të transformimit të institucioneve të përkujdesit rezidencial për fëmijë, duke vlerësuar proceset për bashkëpunimin me stafin e IPSH-ve për ofrimin e shërbimeve alternative. Sipas MSHMS, deri në miratimin e këtyre planeve Shtëpia e Foshnjës “Lulet e Vogla” duhet të vijojë për ofrimin e shërbimit të përkujdesjes në përputhje me standardet në fuqi.

Si konkluzion mund të themi se, shërbimi i ri i krijuar nuk ka arritur me sukses procesin për të fuqizuar familjen dhe për të pozicionuar këta fëmijë në familje kujdestare profesionale apo familje me lidhje gjaku. Shërbimet alternative dhe shërbimet e specializuara nuk janë arritur të sigurohen dhe të ofrohen. Procesi i deinstitutionalizimit po funksionon vetëm në drejtim të largimit të fëmijëve rezident drejt institucioneve të tjera rezidenciale dhe për efekte birësimi e jo për arsye të kthimit të këtyre fëmijëve në familjet e tyre biologjike ose në familje kujdestare. Moratoriumi i vendosur për rastet e reja të fëmijëve që kanë nevojë përinstitutionalizim krijon një problem të ri ekonomik-social i cili është ai i vështirësisë për ndjekjen e kujdestarisë së fëmijës nga familja biologjike si pasojë e institucionalizimit të këtyre fëmijëve në qytete të tjera të Shqipërisë.

Titulli i gjetjes:	Problematika të rezultuara nga procesi i deinstitutionalizimit
Situata:	Shtëpia e Foshnjës, është në proces pilotimi deri në fund të vitit 2022, me qëllim transformimin e shërbimit për të ofruar shërbime alternative referuar VKM nr.706, datë 09.09.2020 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit 2020-2022, dhe të Planit të Veprimit për zbatimin e tij”.

	Në zbatim të Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit, MSHMS ka miratuar projektin e propozuar nga Bashkia Korçë për ngritjen e shërbimeve mbështetëse për fëmijën dhe familjen. Afati i zbatimit të Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit është drejt përfundimit, referuar VKM-s së mësipërme deri në fund të vitit 2022. Nga auditimi i zbatimit të planit të deinstitutionalizimit dhe impaktit që ka pasur në Shtëpinë e Foshnjës “Lulet e Vogla”, Bashkia Korçë, janë konstatuar problematikat si më poshtë: -Objektivat e përcaktuara në projektin e Bashkisë Korçë, miratuar nga MSHMS “Për ngritjen e shërbimeve mbështetëse për fëmijën dhe familjen” nuk janë arritur. Konkretisht, nuk është arritur parandalimi i ndarjes së fëmijëve nga prindërit, përfitimi i shërbimeve të specializuara dhe pilotimi i kujdesit alternativ profesional për fëmijët prindërit e të cilëve nuk mund të ushtrojnë kujdes prindëror për një kohë të caktuar. -Struktura e ngritur nga Bashkia Korçë, “Për Shërbimin dhe Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Familjes”, është angazhuar vetëm në parandalimin e institucionalizimit të fëmijëve dhe jo në deinstitutionalizimin e tyre që aktualisht ndodhen në qendrën rezidenciale. Fëmijët e qendrës rezidenciale Shtëpia e Foshnjës “Lulet e Vogla” janë larguar për arsye birësimi dhe për shkak të arritjes së moshës për transferimin në qendra rezidenciale të tjera për fëmijë të moshës nga 6-18 vjeç dhe jo se janë rikthyer në familje biologjike ose janë pozicionuar në familje kujdestare profesionale. -Në Bashkinë Korçë, mungon një listë e familjeve kujdestare pa lidhje gjaku. Ky fakt, bën të pamundur deinstitutionalizimin e fëmijëve të cilët nuk mund të kthehen në familjet biologjike apo në familje me lidhje gjaku. -Nga pushteti vendor dhe qendror nuk janë hartuar ende plane për transformimin e Shtëpisë së Foshnjës Korçë si institucion dhe si shërbimi si dhe nuk është bërë vlerësimi i kapacitetit të stafit. -Moratoriumi i vendosur për rastet e reja të fëmijëve që kanë nevojë përinstitutionalizim krijon një problem të ri ekonomiko-social i cili është ai i vështirësisë për ndjekjen e kujdestarisë së fëmijës nga familja biologjike si pasojë e institucionalizimit të këtyre fëmijëve në qytete të tjera të Shqipërisë. Për sa më lart, nuk është përmbushur procesi i deinstitutionalizimit në Bashkinë Korçë dhe as ai i transformimit të shërbimeve të ofruara nga Shtëpia e foshnjës “Lulet e Vogla”, për aq kohë sa këta fëmijë do të jenë përsëri objekt i politikave të deinstitutionalizimit në institucionet rezidenciale ku do të shkojnë.
Kriteri:	VKM nr.706, datë 09.09.2020 në zbatim të Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit 2020-2022.
Ndikimi/Efekti:	Probleme sociale – ekonomike.
Shkaku:	Nuk është vepruar në kohë nga Institucionet kompetente.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandim:	-Bashkia Korçë, në bashkëpunim me Shtëpinë e Foshnjës “Lulet e Vogla” Korçë dhe Shërbimin Social Shtetëror, të analizojnë ecurinë e procesit të pilotimit referuar Planit të Deinstitutionalizimit dhe nëpërmjet një raport progresi të evidentohen: sfidat dhe problematikat që janë hasur gjatë procesit të pilotimit për realizimin e objektivave, të

	vlerësohet efektiviteti i tij, sa i zbatueshëm dhe i arritshëm është brenda 5 viteve të ardhshme, në kushtet ekonomiko-sociale që ndodhet vendi. -Raport progresi i hartuar nga institucionet e Kujdesit Social, të dërgohet në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për të vlerësuar dhe marrë masat e nevojshme në lidhje me vënien në zbatim ose jo të Planit të Deinstitutionalizimit. -Bashkia Korçë, të evidentojë dhe vlerësojë familjet e gatshme për të qenë familje kujdestare me qëllim që kjo Bashki, të ketë një listë zyrtare të këtyre familjeve. Në rast se familjet kujdestare nuk mund të evidentohen, të analizohen arsyet dhe ti bëhen me dije Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, pasi mungesa e një liste me familje kujdestare është pengesë për realizimin e planit të Deinstitutionalizimit. -Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Komitetin Drejtues të përpilojë dhe miratojë në kohë një plan për transformimin e institucioneve të përkujdesit rezidencial për fëmijë, duke vlerësuar proceset për bashkëpunimin me stafin e Shtëpisë Foshnjës “Lulet e Vogla” për ofrimin e shërbimeve alternative pasi të merret në analizë ecuria e planit dhe pilotimit deri në dhjetor 2022.
--	---

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

B. MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje nga auditimi: Nga krahasimi kërkesës buxhetore PBA 2019-2021 dhe buxhetit të miratuar për Shërbimin Social Shtetëror, rezulton se plani i rishikuar në total 18,693 mijë lekë ka pësuar pakësim të shpenzimeve në shumën 139 mijë kundrejt planit fillestar. Sipas zërave buxhetor shpenzimet për paga janë pakësuar në shumën 498 mijë lekë, për sigurime shoqërore janë pakësuar në shumën 57 mijë lekë dhe shpenzimet për shërbime janë shtuar në shumën 416 mijë lekë. Buxheti i rishikuar i vitit 2020 rezulton me difference ndaj kërkesës buxhetore të institucionit në total në shumën 2,022 mijë lekë, dhe sipas zërave shpenzimet për paga janë miratuar më pak në shumën 933 mijë lekë, shpenzimet për sigurime janë miratuar më shumë në shumën 5 mijë lekë, shpenzimeve operative janë pakësuar më shumë së kërkesa buxhetore në shumën 1,094 mijë lekë.

Për SHSSH PBA 2019-2021 nuk janë kërkuar shpenzime kapitale për vitin 2020, sepse këto kërkesa duhet të bëhen në Bashkinë Korçë. SHSSH prej vitesh nuk ka pranuar kërkesa për investime pasi këto investime do të bëhen nga pushteti lokal.

Bashkia Korçë, ka planifikuar një fond prej 250 mije lekë dhe çelur gjatë vitit edhe një fond prej 261 mijë lekë, për ndërtim objekti (shtesë kati). Blerja e kompjuterave është realizuar në vlerën 240 mijë lekë por fondet u trashëguan për vitin 2021 njësisë shpenzuese.Vlera e fondeve për ndërtim u trashëgua për vitin 2021.

Nga krahasimi kërkesës buxhetore PBA 2021-2023 dhe buxhetit të miratuar, rezulton se buxheti i rishikuar në vitin 2021 në total 19,606 mijë krahasuar me planin fillestar ka pësuar pakësim shpenzimesh në shumën 580 mijë lekë. Zërat buxhetorë të vitit 2021, kanë pësuar ndryshim kundrejt buxhetit fillestar për paga më shumë në shumën 1,726 mijë lekë dhe shpenzime për sigurime në shumën 33 mijë lekë dhe shërbime për 1,113mijë lekë.

Buxheti i miratuar i vitit 2021 rezulton me diferencë ndaj kërkesës buxhetore në total për më pak në shumën -7,531 mijë lekë, nga të cilat shpenzimet për paga janë miratuar më pak në shumën -

5,924 mijë lekë, shpenzimet për sigurime më pak në shumën -630 mijë lekë dhe shpenzimeve shërbime më pak në shumën -977 mijë lekë.

Përsa i përket shpenzimeve kapitale për SHSSH nuk janë kërkuar shpenzime kapitale për vitin 2021, sipas kërkesës së njësisë shpenzuese, Bashkia Korçë ka miratuar fondin e kërkuar për 120 mijë lekë për sistemin zjarrfikës i cili nuk është realizuar për situatën e krijuar pas procedurës të deinstitutionalizimit, Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; Ligjin nr. 9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Udhëzimin e MFE nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat Standarde të përgatitjes së Programeve Buxhetore Afatmesme”, kreu 7. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.1, faqe 16-26, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1.Rekomandim: Shtëpia e Foshnjës “Lulet e jetës”, në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror dhe Bashkinë Korçë, përpara miratimit të VKM-së për çeljen e fondeve buxhetore, të vlerësojnë rëndësinë dhe prioritetin e kërkesës për zërin “Investime” në llogarinë 231, në funksion të shëndetit, sigurisë dhe mirëqenies së fëmijëve rezident në institucion.

Në vijimësi

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues, për të tre vitet objekt auditimi, nuk kanë dërguar raportet e monitorimit 4-8-12 mujore të buxhetit, të cilat dërgohen në Shërbimin Social Shtetëror. Mungesa e raporteve të monitorimit 4-8-12 mujore, si dhe relacioneve shpjeguese cenojnë monitorimin e performancës financiare të objektivave të politikës së programit të synuara dhe produkteve të parashikuara në buxhetin vjetor, si edhe mungesën e marrjes së masave korrigjuese për përmirësimin e situatës, në kundërshtim me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; Ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 65, si dhe Udhëzimin nr. 22, datë 17.11.2016, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore Pika 42 kapitulli III të 41.2 kapitulli III, Udhëzimin nr. 22, datë 17.11.2016, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore”. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.1, faqet 16-26, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1.Rekomandim: Shtëpia e Foshnjës “Lulet e Vogla” Korçë, për shpenzimet e saj, të marrë masa, që të hartojë raportet e monitorimit 4, 8, 12 mujore, ku të relatohet në lidhje me realizimin e treguesve në raport me parashikimin. Në raportet 8-mujore të paraqesë informacion shtesë për parashikimin e realizimeve të pritshëm deri në fund të vitit, për të evidentuar nëse ky parashikim është më i lartë apo më i ulët se plani fillestar i parashikuar, me qëllim menaxhimin sa më efektiv të fondeve buxhetore, si dhe ndërmarrjen në kohë të veprimeve korrigjuese duke ndryshuar alokimin e burimeve dhe vlerësimin e prioritetëve duke evidentuar impaktin e mundshëm në performancën e objektivave të lidhura me to.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se bashkëlidhur dokumentacionit justifikues të urdhër shpenzimeve, mungonte procesverbali i marrjes në dorëzim të mallrave/shërbimeve të prokuruar në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në njësitë e sektorit publik”. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.5, faqe 34-35, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandim: Komisionet e ngritura për marrjen në dorëzim të mallrave në çdo rast, të hartojnë procesverbale në të cilat të detajohen të dhënat e verifikuara dhe të evidentohet nëse ka mospërputhje me faturën dhe përcaktimet e kontratës dhe më pas të dorëzohen në Sektorin e Financës për likuidimin e pagesave.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat e pozicionit dhe e performancës financiare të vitit 2021, regjistrimi i llogarive kontabël nuk është bërë referuar regjistrimeve në ditarët kontabël por veprimeve ekonomike të rakordura me Degën e Thesarit. Kështu, regjistrimi i të ardhurave dhe shpenzimeve nga personi përgjegjës për financën, nuk bëhet sipas destinacionit por sipas natyrës.

-Nga auditimi ka rezultuar regjistrim i gabuar i llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në llogarinë 4342 “Operacione me shtetit” në vlerën 138,853 lekë, ndërkohë që kjo vlerë nuk paraqitet në asnjë llogari në pasiv, pra nuk ka kundërparti të llogarisë në pasiv.

-Në pasqyrën e ndryshimeve të aktiveve neto/ fondeve neto, llogaria 101 “aktivet neto/fondet neto” nuk është ajo e vitit paraardhës, llogaria 105 “Nga grandet e brendshme kapitale” është pasqyruar në vlerën 0, si dhe nuk është pasqyruar fitimi i vitit ushtrimor. Fondet neto përfshijnë zëra si: teprica apo deficit i akumuluar, rezultatet e mbartura, rezultati i veprimtarisë ushtrimore, rezerva nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata, etj. Për rrjedhojë, mënyra e përlllogaritjes së “Fondit të akumuluar” në pasqyrën e pozicionit financiar nuk është e qartë.

-Në pasqyrën e pozicionit financiar për vitin ushtrimor nuk është pasqyruar llogaria 12 “Rezultatit të mbartur” e cila nga pikëpamja kontabël, në fillim të çdo viti ushtrimor, mbartet si rezultat i vitit ushtrimor të kaluar.

-Nga personi përgjegjës për hartimin e pasqyrave financiare nuk është hartuar regjistri i aktiveve dhe nuk mbahen llogaritë analitike të Aktiveve Afatgjata dhe Afatshkurtra së bashku me llogaritjen e amortizimit të tyre për çdo vit ushtrimor. Sa më sipër veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.4, faqe 36-39, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandim: Përgjegjësi i Sektorit të Administratës, para pasqyrimin të të dhënave në pasqyrat financiare, të regjistrojë në ditarët kontabël të gjitha transaksionet financiare të ndodhura gjatë periudhës ushtrimore.

Menjëherë

4.2.Rekomandim: Përgjegjësi i Sektorit të Administratës, të hartojë regjistrin kontabël të aktiveve dhe të përfshijë si aktivet afatgjata ashtu edhe aktivet afatshkurtra materiale dhe monetare me gjithë të dhënat e nevojshme. Gjithashtu, të hartohen llogaritë analitike dhe të llogaritet amortizimi i aktiveve afatgjata dhe afatshkurta të pasqyruara në pasqyrat financiare.

Brenda datës 31.03.2023

4.3. Rekomandim: Përgjegjësi i Sektorit të Administratës të bëjë sistemimin e llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, llogarisë 4342 “Operacione me shtetit”, llogarisë 101 “Fondit të akumuluar” dhe llogarisë 12 “Rezultatit të mbartur”.

Brenda datës 31.03.2023

5. Gjetje nga auditimi: Procesi i inventarizimit të aktiveve për vitet 2020 - 2021 nuk është bërë duke krahasuar gjendjen kontabël me gjendjen fizike të aktiveve. Procesverbalet për kryerjen e inventarizimit të mbajtura nga komisioni si për inventarin e imët edhe për inventarin ekonomik janë mbajtur për çdo zyrë. Në fund të procesverbaleve mungon vlera totale e aktiveve, të dhënat janë plotësuar me laps si dhe nuk është specifikuar në rast se kanë rezultuar mungesa apo teprica nga ky proces. Në fund të procesit të inventarizimit nuk është hartuar raporti përmbledhës për t’ia paraqitur titullarit gjendjen e inventarit dhe diferencat midis gjendjes kontabël dhe gjendjes fizike në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në njësitë e sektorit publik”. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.4, faqe 36-39, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1.Rekomandim: Titullari i institucionit të marrë masa për kryerjen e inventarëve në fund të çdo viti ushtrimor, duke caktuar në përbërje të komisioneve të inventarizimit të aktiveve specialistë të

fushës, me qëllim kryerjen e inventarizimit me cilësi, pasqyrim të drejtë të procesit të inventarizimit, vlerësimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimi të aktiveve.

Brenda datës 31.03.2023

6.Gjetje nga auditimi: Bashkisë Korçë i është transferuar e drejta e pronësisë së truallit dhe ndërtesës me nr. pasurie 3/62, ZK 8562, vol. 32, faqe 97, me sipërfaqe totale trualli 600 m² dhe sipërfaqe ndërtese 190 m², me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 336, datë 31.05.2006 “Për transferimin në pronësi të disa Bashkive të pronave të cilat janë në përgjegjësi administrimi të drejtorisë së përgjithshme të shërbimit social shtetëror dhe për disa ndryshime në vendimin nr. 60, datë 1.2.2006 të Këshillit të Ministrave për miratimin e listës së inventarit të pronave shtetërore të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi drejtorisë së përgjithshme të shërbimit social shtetëror”, me qëllim vijimin e përdorimit të saj për të ushtruar veprimtarinë institucioni i shtëpisë së foshnjës. Pasuria sipërcituar është pajisur me akte kadastrale, përkatësisht certifikatë për vërtetim pronësie me nr. 235390, lëshuar më datë 25.05.2010. Edhe pse bashkisë Korçë i është transferuar e drejta e pronësisë, nuk rezulton të jetë marrë asnjë masë për përgatitjen dhe azhurnimin e formularit të inventarit të pronës (truall dhe ndërtesë), në kundërshtim me pikën 21, VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.2, faqe 27-34, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1.Rekomandim: Bashkia Korçë (drejtoria e përgjithshme e pronës publike) të marrë masa për përgatitjen e formularit të inventarit të pronës, si dhe azhurnimin e saj në vijim.

Menjëherë dhe në vijimësi

7.Gjetje nga auditimi: Godina ku ushtron veprimtarinë shtëpia e foshnjës “Lulet e vogla” është një ndërtim mbi 50 vjeçar. Bashkia Korçë (drejtoria e përgjithshme e pronës publike), në cilësinë e pronarit të pronës dhe shtëpia e foshnjës “Lulet e vogla”, në cilësinë e njësisë së varësisë që e përdor pronën, nuk rezultojnë të kenë ndërmarrë asnjë procedurë për kryerjen e akt ekspertizës së thelluar të godinës, me qëllim vlerësimin e gjendjes teknike dhe kapacitetin e tij mbajtës, në kundërshtim me nenin 4/1, ligji nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.2, faqe 27-34, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1.Rekomandim: Bashkia Korçë (drejtoria e përgjithshme e pronës publike), të marrë masa për kryerjen e aktekspertizës së thelluar, me qëllim vlerësimin e gjendjes teknike të objektit dhe kapacitetet e tij mbajtëse.

Menjëherë

8.Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi 2020-2022, nuk rezulton të ketë pasur inspektime nga Inspektorati Shtetëror i Shëndetësisë, i cili e ka detyrë funksionale kontrollin e zbatimit të kriterëve e të kushteve nga subjektet publike që ushtrojnë veprimtari të ofrimit të shërbimeveshoqërore, në kundërshtim me nenin 35, ligji 121/2016 “Përshërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.2, faqe 19-26, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1.Rekomandim: Inspektorati Shtetëror i Shëndetësisë të marrë masa për të parashikuar në planin vjetor, kryerjen e inspektimeve në ambientin ku ushtron veprimtarinë shtëpia e foshnjës “Lulet e Vogla”.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Për vitet 2020, 2021, janë realizuar 2 procedura me objekt “Blerje ushqime”. Në ngritjen e komisionit për hartimin e kriterëve dhe specifikimeve teknike, ka rezultuar se asnjë prej anëtarëve të komisioneve nuk janë specialist të fushës së objektit të prokurimit. Në dy procedurat e mësipërme me natyrë blerje ushqimesh, në të cilët kërkohet njohuri të specializuara për kriteret e kapacitetit teknik, formimi profesional i specialistit të fushës, nuk

përputhet plotësisht me natyrën e objektit të prokurimit veprim në kundërshtim me kërkesat e nenit 57, pika 2 të VKM 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

OE nuk përmbush kriterin e pikës 2.6 të DST-ve, ku citohet “Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Certifikatë të Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore ISO 22000:2018 ose ekuivalente me të” certifikatë kjo që nuk disponohet nga OE, veprim në kundërshtim me pikën 2 të nenit 57 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, dhe pikës 4 të nenit 74 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.5, faqe 40-49, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1.Rekomandim: Titullari i AK, të marrë masa në vijimësi për ngritjen e komisioneve të zhvillimit të procedurave të prokurimit me specialist të fushave të caktuara sipas objektit të prokurimit në përputhje me përcaktimet ligjore, me qëllim hartimin e kriterëve/specifikimeve teknike që mundësojnë përdorimin me efektivitet të fondeve publike.

Menjëherë dhe vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Në 7 raste të audituara në procedurat e prokurimit *Blerje me vlera të vogla*, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim të mallit, dhe në disa raste likuidimi i mallit është bërë pa i marrë ato në dorëzim. Në 3 raste të audituara likuidimi i faturave është tej afatit ligjor 30 ditë, veprim në kundërshtim me nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.06.2009 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.3, faqe 40-49, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1. Rekomandim: Autoriteti Kontraktor të marrë masa që komisionet e blerjeve me vlera të vogla, të administrojnë me procesverbal marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve, gjithashtu sektori i financës të ndjekë afatet për likuidimin e faturave brenda afateve ligjore, me qëllim prokurimin e tyre sipas kriterëve dhe cilësinë e kërkuar.

Në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Shtëpia e Foshnjës, është në proces pilotimi deri në fund të vitit 2022, me qëllim transformimin e shërbimit për të ofruar shërbime alternative referuar VKM nr.706, datë 09.09.2020 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit 2020-2022, dhe të Planit të Veprimit për zbatimin e tij”. Afati i zbatimit të Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit është drejt përfundimit. Nga auditimi i zbatimit të planit të deinstitutionalizimit dhe impaktit që ka pasur në Shtëpinë e Foshnjës “Lulet e Vogla”, Bashkia Korçë, janë konstatuar problematikat si:

-Objektivat e përcaktuara në projektin e Bashkisë Korçë, miratuar nga MSHMS “Për ngritjen e shërbimeve mbështetëse për fëmijën dhe familjen” nuk janë arritur. Konkretisht, nuk është arritur parandalimi i ndarjes së fëmijëve nga prindërit, përfitimi i shërbimeve të specializuara dhe pilotimi i kujdesit alternativ profesional për fëmijët prindërit e të cilëve nuk mund të ushtrojnë kujdes prindëror për një kohë të caktuar.

-Struktura e ngritur nga Bashkia Korçë, “Për Shërbimin dhe Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Familjes”, është angazhuar vetëm në parandalimin e institutionalizimit të fëmijëve dhe jo në deinstitutionalizimin e tyre që aktualisht ndodhen në qendrën rezidenciale. Fëmijët e qendrës rezidenciale Shtëpia e Foshnjës “Lulet e Vogla” janë larguar për arsye birësimi dhe për shkak të arritjes së moshës për transferimin në qendra rezidenciale të tjera për fëmijë të moshës nga 6-18 vjeç dhe jo se janë rikthyer në familje biologjike ose janë pozicionuar në familje kujdestare profesionale.

-Në Bashkinë Korçë, mungon një listë e familjeve kujdestare pa lidhje gjaku. Ky fakt, bën të pamundur deinstitutionalizimin e fëmijëve të cilët nuk mund të kthehen në familjet biologjike apo në familje me lidhje gjaku.

-Nga pushteti vendor dhe qendror nuk janë hartuar ende plane për transformimin e Shtëpisë së Foshnjës Korçë si institucion dhe si shërbimi si dhe nuk është bërë vlerësimi i kapacitetit të stafit.

-Moratoriumi i vendosur për rastet e reja të fëmijëve që kanë nevojë për institucionalizim krijon një problem të ri ekonomiko-social i cili është ai i vështirësisë për ndjekjen e kujdestarisë së fëmijës nga familja biologjike si pasojë e institucionalizimit të këtyre fëmijëve në qytete të tjera të Shqipërisë.

Për sa më lart, nuk është përmbushur procesi i deinstitutionalizimit në Bashkinë Korçë dhe as ai i transformimit të shërbimeve të ofruara nga Shtëpia e foshnjës “Lulet e Vogla”, për aq kohë sa këta fëmijë do të jenë përsëri objekt i politikave të deinstitutionalizimit në institucionet rezidenciale ku do të shkojnë, veprime në kundërshtim me VKM nr.706, datë 09.09.2020 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit 2020-2022, dhe të Planit të Veprimit për zbatimin e tij”. (Trajtuar më hollësisht në pikën 2.6, faqe 50-54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1.Rekomandim: Bashkia Korçë, në bashkëpunim me Shtëpinë e Foshnjës “Lulet e Vogla” Korçë dhe Shërbimin Social Shtetëror, të analizojnë ecurinë e procesit të pilotimit referuar Planit të Deinstitutionalizimit dhe nëpërmjet një raport progresi të evidentohen: sfidat dhe problematikat që janë hasur gjatë procesit të pilotimit për realizimin e objektivave, të vlerësohet efektiviteti i tij, sa i zbatueshëm dhe i arritshëm është brenda 5 viteve të ardhshme, në kushtet ekonomiko-sociale që ndodhet vendi.

Brenda 3 muhorit të I të vitit 2023

11.2. Rekomandim: Raport progresi i hartuar nga institucionet e Kujdesit Social, të dërgohet në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për të vlerësuar dhe marrë masat e nevojshme në lidhje me vënien në zbatim ose jo të Planit të Deinstitutionalizimit.

Brenda 6 muhorit të I të vitit 2023

11.3. Rekomandim: Bashkia Korçë, të evidentojë dhe vlerësojë familjet e gatshme për të qenë familje kujdestare me qëllim që kjo Bashki, të ketë një listë zyrtare të këtyre familjeve. Në rast se familjet kujdestare nuk mund të evidentohen, të analizohen arsyet dhe ti bëhen me dije Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, pasi mungesa e një liste me familje kujdestare është pengesë për realizimin e planit të Deinstitutionalizimit.

Brenda 3 muhorit të I të vitit 2023

11.4. Rekomandim: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Komitetin Drejtues të përpilojë dhe miratojë në kohë një plan për transformimin e institucioneve të përkujdesit rezidencial për fëmijë, duke vlerësuar proceset për bashkëpunimin me stafin e Shtëpisë Foshnjës “Lulet e Vogla” për ofrimin e shërbimeve alternative pasi të merret në analizë ecuria e planit dhe pilotimit deri në dhjetor 2022.

Brenda 6 muhorit të I të vitit 2023

V. ANEKSE

SQARIM RRETH LLOJEVE TË NDRYSHME TË OPINIONEVE TË APLIKUARA NGA KLSH.

Llojet e opinionëve të aplikuar nga KLSH.

a. OPINIONI I PAMODIFIKUAR:

Një opinion i pamodifikuar jepet kur audituesi arrin në konkluzionin se për të gjitha aspektet materiale, pasqyrat financiare paraqesin një pamjen të vërtetë dhe të drejtë si dhe pasqyrat janë përgatitur në përputhje me bazën ligjore në fuqi për raportimin financiar. Audituesi duhet të tërheq vëmendjen e përdoruesit për një ose disa çështje të paraqitura ose të evidentuara në pasqyrat financiare, të cilat janë të rëndësishme për të kuptuar pasqyrat financiare. Përdoruesit e pasqyrave financiare në sektorin publik janë ligjvënësit, Parlamenti, komitetet mbikëqyrëse, komisione të ndryshëm dhe qytetarët, të cilët janë dhe përdoruesit e fundit.

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes.

Në rrethana të caktuara, audituesi mund të marrë në konsideratë faktin se lexuesi nuk do të arrijë në kuptimin e saktë të pasqyrave financiare nëse atij nuk do t'i tërhiqet vëmendja mbi çështjet të pazakonta ose të rëndësishme. Si parim i përgjithshëm, audituesi nuk i referohet aspekteve specifike të pasqyrave financiare kur jep një opinion të pamodifikuar, në rast se kjo ndodh mund të keqinterpretohet si modifikim. Për të evituar dhënien e kësaj përshtypje të gabuar, referencat e menduara si “theximi i çështjes” përfshihen në një paragraf të veçantë nga ai i opinionit. Theximi i referohet një çështjeje të paraqitur ose shpalosur në mënyrë të duhur në pasqyrat financiare e cila, sipas gjykimit të audituesit, ka një rëndësi thelbësore për përdoruesin në mënyrë që të arrijnë të kuptojnë pasqyrat financiare. (ISSAI 1706.5).

Opinion i kualifikuar/i cilësuar, jepet në ato raste kur është marrë siguri e arsyeshme, është siguruar një evidencë e mjaftueshme dhe e plotë, por janë evidentuar raste të mospërrputshmërisë me kriteret e aplikuar, të cilat janë *materiale, por jo të përhapura*, ose kur audituesi nuk është në gjendje të mbledhë prova të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, dhe efektet e mundshme janë materiale, por jo të përhapura.

b. OPINIONET E MODIFIKUARA:

Audituesi duhet të modifikojë opinionin në rastet kur:

- Bazuar në evidencat e auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi përmbajnë anomali materiale; ose
- Nuk është në gjendje të sigurojë evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për auditimin. (ISSAI 1700.4;6;17).
- Evidentohet që njësia ekonomike nuk ka përmbushur përgjegjësitë e përcaktuara nga legjislacioni i raportimit financiar për:
 - Prezantimin e drejtë të informacionit financiar.
 - Mos plotësimin e të gjitha kërkesave ligjore të raportimit financiar. (ISSAI 1700.18;19)
- Evidentohen raste që lidhe me mosrespektimin e legjislacionit ose dobësi të kontrollit të brendshëm, të cilat ka një efekt material ose të përhapur në pasqyrat financiare. (ISSAI 1705 P4; P5; P6)

Përhapja është një term i përdorur për të përshkruar efektet në pasqyrat financiare të anomalive ose efektet të mundshme nëse ka, që nuk zbulohen për shkak të pa mundësisë për të marrë evidenca të mjaftueshme të auditimit. Përhapja e gjetjes do të përcaktojë llojin e opinionit të modifikuar të auditimit i cili do të jepet.

Efektet e përhapjes në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të audituesit: Nuk kufizohen në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare; Mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose janë të rëndësime për përdoruesit e pasqyrave financiare. (ISSAI 1700.5)

Audituesi duhet të zgjedhë opinionin më të përshtatshëm të modifikuar nga 3 opsionet e përshkruara më poshtë:

Opinion i modifikuar. Opinion i modifikuar do të jepet në rastet kur audituesi nuk është dakord ose është i pasigurt për një ose më shumë çështje specifike që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare të cilat janë materiale por jo thelbësore për arsyetimin e pasqyrave. Formulimi i opinionit zakonisht tregon një rezultat të kënaqshëm të subjektit të auditimit në një deklaratë të qartë dhe koncize të çështjeve të mospajtimit ose të pasigurisë, duke çuar në opinionin e modifikuar. Nëse efekti financiar i paqartësisë apo i mosmarrëveshjes është i përcaktuar si shumë nga audituesi, ndonëse nuk është gjithmonë e praktikuar ose e përshtatshme, atëherë kjo do të shërbente si ndihmë për përdoruesit e pasqyrave.

Opinion negativ (kundërshtues). Opinion negativ (kundërshtues) do të jepet në rastet kur audituesi e ka të pamundur të krijojë një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, si pasojë e mospërputhjes aq shumë vendimtare sa të përmbys situatën e paraqitur në atë masë që një opinion i modifikuar në aspekte të caktuara nuk do të ishte i përshtatshëm. Formulimi i këtij opinion qartëson faktin se pasqyrat financiare nuk janë deklaruar saktësisht duke specifikuar në mënyrë të thjeshtë dhe koncize të gjitha rastet e mospërputhjes. Gjithashtu, aty ku është me vend dhe e praktikueshme, do të ishte e dobishme sikur ndikimi financiar mbi pasqyrat financiare të përcaktohej në shumë.

Refuzim i opinionit. Refuzimi i opinionit do të jepet në rastet kur audituesi e ka të pamundur që të mbërrijë në një opinion për sa i përket pasqyrave financiare të marra në tërësi, si pasojë e pasigurisë apo e kufizimit të fushëveprimit aq shumë thelbësor, në mënyrë që një opinion i kualifikuar në disa aspekte të caktuara të mos jetë i përshtatshëm. Formulimi i refuzimit të opinionit qartëson faktin se është e pamundur të jepet një opinion duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha rastet e paqartësisë.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT